

AHMED IZZUDDIN EL-BEJANUNI

400

KËSHILLA ISLAME

Zvicër, 2009

Titulli në original:
400 نَصِيحَةٌ إِسْلَامِيَّة

Titulli në gjuhën shqipe:
400 KËSHILLA ISLAME

Autor:
Ahmed Izzuddin El-BEJANUNIJ

E shqipëroi nga gjuha arabe:
Mr. Sci. Fehim Xhafer DRAGUSHA

Redaktor profesional:
Muhamed DËRMAKU (Profesor)

Redaktor gjuhësor:
Ermal BEGA

Tirazhi 3000 copë
Botimi i parë

**Copyright© 2009 Xhamia El-Hidaje, Herisauerstrasse 52,
Saint Gallen, Zvicër.**

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij libri nuk mund të riprodhohet apo transmetohet përmes çdo lloj mënyre apo mjete, qoftë elektronik apo mekanik, përfshirë fotokopjimin, incizimin në audio, apo përdorimin e çdo lloj mënyre të ruajtjes së informacionit, pa lejen paraprake të botuesit.

AHMED IZZUDDIN EL-BEJANUNIJ

400

KËSHILLA ISLAME

Përktheu dhe përshtati nga gjuha arabe:
Mr. Sci. Fehim Xh. Dragusha



*Kryesia e Bashkësisë Islame "El-Hidaje",
Islamischen Gemeinschaft, Herisauerstrasse 52,
Saint Gallen Zvicer, 2009
www.el-hidaje.ch*



FJALA E REDAKTORIT FETAR

Falënderimi absolut i takon vetëm Allahut, Zotit të botëve. Lavdërimi dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të Dërguarin e Tij Muhamedin, mbi familjen, mbi shokët e tij dhe mbi ata që e ndjekin atë me përpikëri deri në Ditën e Gjykimit!

Është e njohur se për të folur shkurt duhet menduar gjatë.

Njerëzit në përgjithësi janë në gjendje të dëgjojnë gjatë, por jo edhe të lexojnë gjatë, andaj në situata të caktuara, do të ishte më se e nevojshme që lexuesi të posedonte ndonjë udhëzues të shkurtër që shërben për arsimim dhe flet për situata të ndryshme të jetës, e sidomos në jetën fetare.

Mendoj se këtë nevojë e mbulon tejet mirë libri “400 Këshilla Islame” i autorit Ahmed El-Bejanuni. Në mënyrë tejet të shkurtër, në format të vogël, me shprehje të lehta e të qarta, autori në 20 kapituj ofron katërqind këshilla që kanë të bëjnë me sfera të ndryshme të jetës. Këshillat bëhen me porosinë “veprojeni këtë” për gjërat që duhet vepruar, por që mund t’i neglizhojmë dhe “mos e veproni këtë” për gjërat që njerëzit kanë prirje t’i veprojnë e që në realitet veprimi i tyre është i dëmshëm për besimin dhe jetën e tyre.

400 këshillat përfshijnë jetën e përditshme të një muslimani duke filluar nga ana shpirtërore, përcaktimi i vijës fetare, motivimi për vepra të mira, të shëndosha dhe të dedikuara drejtë, përfshijnë ritet islame ditore, javore, mujore, vjetore e të jetës, pastaj parimet ekonomike e tregtare, jetën martesore, veshmbathjet, ushqimet, udhëheqjen, kodin penal, kodin etiko-moral etj.

Shkalla e dispozitës praktike të Sheriatit nuk është e sqaruar për çdo këshillë veç e veç. Me fjalë të tjera nga 400 këshillat që i përmban ky libër, ka disa që janë të nivelit obligues (farz e vaxhib), preferues (mendub), të urryera (mekruh) e ndalues (haram).

Vlen të theksohet se këto këshilla, në disa raste përkthyesi i ka pasuruar me të dhëna shtesë, duke sqaruar në fusnota disa dispozita të veçanta, që lexuesit shqiptar i nevojiten t'i njohë.

Ky libër e pasuron edhe më shumë bibliotekën islame në gjuhën shqipe, e sidomos këndin që do t'i përngjante “ushqimeve të shpejta” (fast food) në industrinë ushqimore.

Allahu e shpërbleftë me të mira autorin e librit, që i përmbodhi këto këshilla si dhe përkthyesin, kolegun tim, mr. Fehim Dragusha për punën e tij vetëmohuese në nxjerrjen e këtij libri në gjuhën shqipe duke i dëshiruar suksese të mëtejshme për nxjerrjen e titujve të tjerë të dobishëm!

400 KËSHILLA ISLAME

- Pastroje qëllimin për hir të Allahut të Madhërishëm dhe ruaju nga hipokrizia si në thënie, ashtu edhe në vepra!
- Pasoje traditën [Sunnetin] e të dërguarit të fundit, Muhamedit [alejhisselam], në të gjitha thëniet, veprat si dhe në parimet morale!
- Frikësoju Allahut të Madhërishëm dhe përcaktohu për kryerjen e gjithë urdhrave [obligimeve] dhe mënjanimin e gjitha të ndaluarave [haramëve]!
- Kthehu tek Allahu me një pendim të sinqertë dhe shtoje istigfarin [kërko falje nga Allahu më shumë] duke thënë Estagfirullah!
- Frikësoju Allahut Fuqiplotë në të gjitha lëvizjet dhe ndalesat e tua!
- Nënshetroju dispozitave të Fesë Islame, sepse me të vërtetë feja islame është nënshtrim dhe bindje ndaj Allahut; ke kujdes nga vlerësimi i gjërave sipas mendjes sate, sepse mendja ka një kufi, që s'mund ta kalojë, ashtu siç ka edhe të shikuarit kufi ku përfundon së shikuari!
- Ulu me dijetarët [ulematë], duaji ata, përfito prej tyre dhe bëhu i thjeshtë në raport me ta! Gjithashtu edhe fëmijët e tu mësoji në këtë mënyrë, sepse dijetarët janë trashëgimtarët e të dërguarve të Allahut!
- Dëgjoji këshillimet me përkushtim dhe përfito prej tyre!
- Pranoje të vërtetën nga ai që e thotë, qoftë i madh apo i vogël, dhe ruaju nga kokëfortësia dhe mendjemadhësia!

- Pastroje besimin [Akiden] sipas kërkesave të Kur'anit dhe Sunnetit dhe ruaju prej doktrinave dhe shprehjeve të cilat të shprien në mosbesim [Kufër]!
- Beso në Allahun e Madhërishëm, në engjëjt [Melaiket] e Tij, në Librat [Kitapët] e Tij, në të dërguarit e Tij, në Ditën e Fundit, dhe se ndodhia e ngjarjeve [Kaderi], qofshin të mira apo të këqija, ndodh me caktimin e Allahut të Lartësuar!
- Mos i paso të tjerët në mënyrë të verbër!
- Mos thuaj lidhur me Kur'anin asgjë sipas mendimit tënd (mos thur komente sipas qejfit tënd), por mbështetu në transmetimet autentike!
- Insisto në leximin e librave shkencorë në mënyrë të vazhdueshme dhe këmbëngul në arsimimin e njerëzve, sepse njeriu më i mirë është ai që arsimohet dhe arsimon të tjerët!
- Medoemos duhet të posedoni ndonjë libër fikhu (jurisprudence) sipas shkollës juridike (Medh'hebit) të cilës i takon¹⁾
- Patjetër duhet të posedoni këta libra: "Rijadus-sàlihīn" të autorit [Imam En-Neveviut], librin: "Núrul Jekín Fissíreti" të autorit [El-Hudarij], librin: "El-Edhkár" të autorit [Imam En-Neveviut], si dhe libra të ngjashëm me këta që u cekën!
- Largohu nga shfletimi i revistave imorale (me përmbajtje erotike) dhe shmangu nga leximi i librave që janë në kundërshtim me Islamin!

¹⁾ Mbi këtë këshillë autori Ahmed Izzudin El-Bejanuni nuk ka cekur ndonjë medhheb të veçantë duke pasur parasysh se në çdo vend apo provincë pasojnë medhhebe të ndryshme (Shënim i Përkthyesit - Sh. P.).

- Nxito në punët e mira, sepse do të shpërblehesh dhe do të arrish sa shpërblimi [sevapi] i të gjithë atyre që të pasojnë ty!

KËSHILLA RRETH PASTËRTISË

- Hy në tualet duke filluar me këmbën e majtë! Para se të hysh në të, kërkoni mbrojtje-strehim nga Allahu², dhe mos bisedo asgjë brenda saj! Kur ta kryeni nevojën, dilni me këmbën e djathtë duke shqiptuar këtë lutje: Gufráneke!
- Keni kujdes nga të kryerit e nevojës nëpër rrugë apo nën hije³, sepse një gjë e tillë i lëndon njerëzit!
- Gjatë kryerjes së nevojës nuk duhet të ktheheni nga kibla, e as t'ia ktheni shpinën asaj, përveç nëse jeni brenda ndonjë objekti!
- Mënjanoje urinimin në këmbë, aq sa keni mundësi, për shkak që mos t'ju bien stërpikat e saj!⁴

²) Që t'ju ruajë nga të këqijat e shejtanit të mallkuar!

³) Këtu është për qëllim vendi nën hijen e pemëve, ku njerëzit gjatë stinës së verës si rezultat i temperaturave të larta, preferojnë që kohën e tyre ta kalojnë nën hijen e pemëve. (Sh. P.)

⁴) Ka shumë raste ku tualetet e muslimanëve nuk janë të rregulluara sipas parimeve islame, në fakt ato i ngjajnë tualeteve të huaja joislame, të cilët pa marrë parasysh se ku na shpie, shumë prej shqiptarëve në këtë rast, kanë bërë konstruktimin e tualeteve që urinën ta kryejnë gjatë qëndrimit në këmbë. Në të shumtën e rasteve është e pamundur t'i ikësh spërkatjeve. Dihet fare mirë nga historia e bujshme islame se i Dërguari i Allahut [alejhis-selam], duke kaluar pranë disa varrezave kishte treguar që njëri prej të vdekurve është duke u dënuar, vetëm se nuk i kishte kushtuar rëndësi kryerjes së nevojës së vogël. Feja Islame edhe në këtë lëmi ka vendosur bazat dhe rregullat e kryerjes së nevojës së madhe dhe asaj të vogël, prandaj

- Ruaju nga urina, dhe pas mbarimit të urinimit, duhet të pastroni organin gjenital me gurë apo letër, po pate mundësi, pastaj me ujë, sepse përdorimi i të dyjave është më mirë...!
- Mos i shfryni hundët me dorën e djathtë, as mos e pastroni nevojën e madhe me të e as mos e përdorni atë për gjëra të ndyra, por në këto raste përdorni dorën e majtë!
- Bëjini fëmijët synet⁵ kur janë të vegjël, sepse synetimi konsiderohet si normë islame!

të gjithë ata që dëshirojnë të jetojnë një jetë në baza të shëndosha islame, i këshilloj që të ruhen nga urina, ngase siç thotë edhe i Dërguari i Allahut [alejhis-selam]: “Pastërtia është gjysma e besimit”, prandaj mbetet që t’i zbatojmë thëniet e Muhamedit alejhis-selam. (Sh. P.)

⁵⁾ Synetimi është fjalë e gjuhës arabe, e cila është huazuar në gjuhën turke, shqipe dhe shumë të tjera me një kuptim tjetër nga ai që është në gjuhën arabe. Meqë synetimi është traditë profetike, atëherë tek popujt joarabë është huazuar nga fjala sunnet. Në gjuhën arabe, si term i përshtatshëm për operacionin e rrethprerjes ekziston shprehja El Hitan الختان. Në terminologjinë fetare synetimi do të thotë: “Prerja përreth e lafshës në organin gjenital, në të cilën mblidhet pjesa e mbetur e urinës, ku nuk mund të pastrohet nga brendësia dhe as era e saj e pakëndshme nuk mund të largohet. Është me rëndësi të përmendim se Imam Maliku dhe të tjerët transmetojnë nga Jahja Ibën Seid se ky e kishte dëgjuar Seid Bin Musejjebin duke thënë: “Ibrahimi është i pari që u bë synet, i pari që priti mysafir, i pari që i rruajti qimet rreth organeve gjenitale, i pari që preu thonjtë, i pari që shkurtoi mustaqet dhe i pari që u thinj. Kur e pa këtë (të thinjurit) tha: Çfarë është kjo (o Zoti im)? Allahu tha: Urtësi. Ibrahimi tha: O Zot! Ma shto urtësinë! (Sh. P.)

KËSHILLA RRETH ABDESIT

- Bëhuni gati për abdes, përtërije atë dhe përpiqu që gjithmonë të jesh i pastër me abdes!
- Mos flejë, vetëm duke qenë i pastër me abdes!
- Përmende emrin e Allahun të Madhërishtëm para marrjes së abdesit duke thënë: Bismilah!
- Përdore misvakun⁶ para çdo abdesi dhe para çdo namazi!

⁶) Misvaku ka formën e drurit, ka lloje të shumta të misvakut. Në kohën e të Dërguarit [alejhis-selam], misvaku përdorej për pastrimin e dhëmbëve, me një fjalë, misvaku luan rolin e brushës të cilën ne e përdorim sot, prandaj përdorimi i tij është prej traditës së Muhamedit [alejhis-selam]. Edhe sot e kësaj dite misvaku përdoret në vendet islame dhe si i tillë shitet në të gjitha dyqanet që shesin artikuj dhe produkte islame. Vlen të përmendet se misvaku ishte i njohur edhe para Islamit, por Islami shtoi disa gjëra për përdorimin e tij. I Dërguari i Allahut, Muhamedi [alejhis-selam] ka rekomanduar përdorim të përditshëm të misvakut, veçanërisht pasi të zgjohemi nga gjumi; kur marrim abdes, kur lexojmë Kur'an, para se të flemë dhe kur goja ka erë të keqe. Ekzistojnë një mori hadithesh që flasin për misvakun. Transmetohet nga Aishja [radijallahu anha] se Muhamedi [alejhis-selam] ka thënë: *“Dhjetë gjëra janë të natyrshme (për këdo që t'i bëjë): Rregullimi i mustaqeve, rritja e mjekrës, përdorimi i misvakut, thithja e ujit me hundë, prerja e thonjve, larja e duarve, shkulja e qimeve të sqetullave, rruajtja e qimeve në vendet e turpshme dhe ruajtja e ujit.”* (Transmeton Muslimi). Gjithashtu në një hadith tjetër ka thënë: *“Po të mos i krijonte vështirësi njerëzve të Ummetit tim, do t'i urdhëroja ata që ta përdorin misvakun para çdo abdesi dhe namazi.”*

Misvaku është një bimë natyrale që shërben për larjen e dhëmbëve. Ai merret nga degët e pemëve të veçanta në shkretëtirë. Ndryshon

- Gjatë pastrimit të gojës dhe hundës, tregohu i përpiktë, përveç nëse jeni agjërues!
- Pastrojini me kujdes gjymtyrët e trupit, dorën futeni brenda mjekrës (në mënyrë që uji të depërtojë në tërësi), në mes të gishtërinyve të duarve dhe të këmbëve, dhe plotësojeni abdesin tuaj!
- Gjithmonë filloni nga e djathta⁷!

nga një krahinë në tjetrën por në Arabi dhe Azi merret nga një pemë e quajtur “arak”. Ky është lloji më i njohur të cilin e kishte përdorur edhe i Dërguari [alejhis-selam]. Në shkencë misvaku njihet me emrin *Salvadora Persika*. Meqë pema arak është shumë e njohur dhe meqë e ka përdorur i Dërguari [alejhis-selam] është studiuar gjerësisht nga shkenca. Këtu do të përmbledhim disa zbulime të ndryshme. Është një pemë që rritet në vende të nxehta ekuatoriale, veçanërisht në luginat e shkretëtirës. Është e përhapur në jug të Arabisë Saudite, Jemen, Sudan, Egjipt, etj. *Salvadora Persika* është një pemë e drejtë, me blerim të përhershëm dhe e vogël me gjatësi maksimale deri në tre metra. Gjethet i ka të vogla, të rrumbullakëta, të shëndetshme dhe të lëngshme, me aromë të fortë pishe ose mustarde. Pa dyshim se çdo urdhër që vjen nga Allahu i Madhërishtëm dhe i Dërguari [alejhis-selam], duhet ta marrim, për shkak se aty hasim vetëm të mira dhe dobi të ndryshme shëndetësore. Pasta natyrale e misvakut përbëhet nga një numër i madh substancash, të cilat luajnë një rol të rëndësishëm në pastrimin e dhëmbëve. Shumë studiues kanë arritur në përfundimin se misvaku përmban mbi dhjetë lloje përbërësish kimikë natyralë, të cilët konsiderohen si esenciale për një higjienë të mirë të gojës dhe të dhëmbëve. Disa nga këta komponentë janë zhvendosës papastërtish dhe zbardhues dhëmbësh, disa i mbrojnë dhëmbët nga kariesi, disa të tjerë janë bakteriologjikë dhe antiseptikë, të tjerat ndihmojnë për shërimin dhe përmirësimin e indeve, disa ndihmojnë mineralizimin e sërishëm të zmallit të dhëmbëve dhe disa japin shije dhe aromë. (Sh. P.)

⁷ Feja Islame na urdhëron që çdo punë ta fillojmë nga e djathta, jo vetëm në abdes, por në të gjitha sferat e jetës, si fjala vjen: kur të flegmë të kthehemi nga kibla (apo në krahun e djathtë), të ushqehemi

- Me duar të lagura përshkoni tërë kokën [jepini mes'h]!
- Përshkoji veshët me duar të lagura nga brenda dhe nga jashtë [mes'h].
- Me sa mundësi të keni, pas çdo abdesi falni dy rekate namaz!

me dorën e djathtë, të pranojmë dhe të dorëzojmë gjëra me dorë të djathtë etj.

KËSHILLA RRETH GUSLIT

- Mos e toleroni veten, e as gratë dhe fëmijët tuaj, që ta vonojnë pastrimin nga papastërtia [xhunubllëku]⁸, ku si rezultat i vonesës mund të vijë deri te vonimi i faljes së namazit apo edhe lënia fare e tij!
- Mos hyni në xhami duke qenë i papastër [xhunub], përveç nëse jeni kalimtar rasti! Po ashtu mos lejoni që gratë tuaja të hynë në xhami kur ato janë me të përmuajshme dhe në periudhën e lehonisë [hajz dhe nifas]!
- Mos i zbuloni pjesët e turpshme [auretin] si dhe ndaloji të tjerët nga kjo me butësi!
- Mos i lejoni gratë e familjes tënde të shkojnë në banjë publike⁹, ngase ekspozimi dhe lakuriqësia e grave në të është gjë e pashmangshme!

⁸) Këtu bëhet fjalë për xhunubllëkun - papastërtinë nga mënyra të ndryshme si p.sh. marrëdhëniet seksuale, dalja e spermës vetvetiu apo me anë të ngacmimit, ejakulimi nëpërmjet ëndrrave në gjumë, e kështu me radhë. Në të gjitha këto raste obligohet pastrimi i trupit dhe nuk na lejoheq që të hyjmë në namaz e as të qëndrojmë në xhami duke qenë të papastër, por duhet që sa më parë të gjejmë ujë dhe të pastrohemi në tërësi. (Sh. P.)

⁹) Për fat të keq në vende të banuara me muslimanë, ekspozimi i bukurive trupore nga gjinia e kundërt është edhe më i madh se ai në banjë publike. Hapja e pishinave në vendet tona, rregullimi i plazheve, ka bërë që shumë nga vëllezërit dhe motrat tona, të shfrytëzojnë rastin për ekspozim dhe reklamim të trupit. Dihet fare mirë se të gjitha pishinat dhe plazhet janë të përziera. Aty mund të shkojë kush të dojë dhe të vishen si të duan. Jo vetëm kaq, por edhe

- Merrni avdes para guslit [para larjes së tërë trupit], ashtu siç merrni për namaz!
- Filloni me larjen e trupit me ujë dhe fërkoni çdo pjesë të trupit me të!
- Gjatë pastrimit të trupit, paralel me nijetin filloni hedhjen e ujit në kokë, pastaj vazhdoni me krahun e djathë, pastaj të majtin, nga tri herë!

rrugëve dhe shesheve gjejmë një lakuriqësi marramendëse, sidomos tek gjinia femërore. A do të thotë se ardhja e verës dhe pushimet verore të shfrytëzohen në këtë mënyrë, duke parë motrat tona shqiptare të veshura në bikini dhe sikur asgjë s'ka ndodhur. Mosnjohja e Islamit ka bërë që e tërë kjo të merret si një punë e thjeshtë. Unë nuk them se Islami ndalon që të dëfrehemi, mirëpo duhet pasur parasysh se për çdo gjë në këtë glob ka rregulla dhe norma që Allahu i Plotfuqishëm ka vënë për njerëzit, prandaj, nëse këto plazhe janë të rregulluara sipas normave islame, pra të jenë të ndara, për burrat vend i posaçëm, për gratë vend i posaçëm, kjo do të ishte në rregull, pasi ka njerëz që me të vërtetë kanë nevojë të shërohen nga sëmundje të ndryshme dhe t'i kalojnë ca ditë në bregdet. E lusim Allahun që udhëzimi i Tij t'i mbulojë trevat tona dhe njëherë e përgjithmonë Islami të kuptohet ashtu si duhet. (Sh. P.)

KËSHILLA RRETH NAMAZIT

- Përpiqu që t'i përgjigjesh thirrjes së muezinit për namaz, ashtu siç ka ardhur në traditën profetike, dhe nga ky obligim, mos të pengojë asnjë bisedë, punë, e asnjë adhurim tjetër po ishte e mundur!¹⁰
- Dërgo salavate mbi të Dërguarin, lavdërimi dhe paqja e Allahut qofshin mbi të, fill pas përfundimit të ezanit dhe lute Allahun e Madhëruar me lutjen [duanë] përkatëse!¹¹
- Mos dil nga xhamia pas thirrjes së ezanit, përveç nëse ke ndonjë arsye të domosdoshme!
- Nëse nuk merr pjesë në xhami, atëherë thirre ezanin vetë kur ta falësh namazin!
- Ikametin thuaje para çdo namazi të obliguar - farz!
- Në mes të ezanit dhe ikametit, lute Allahun e Madhëri-shëm për veten dhe mbarë muslimanët për çfarë të duash nga nevojat e Dynjasë dhe të Ahiretit!

¹⁰) Është fjala të pasohet muezini, duke i shqiptuar fjalët e ezanit pas tij, përveç kur ai thotë "HAJJE ALES-SALA" dhe "HAJJE ALEL-FELAH", sipas traditës profetike duhet të thuhet: "LA HAVLE VE LA KUVVETE IL-LA BIL-LAH". (Sh. P.)

¹¹) *Allahumme rabbe hádhili ed-da'vetit-támmeh, vessalátil káimeh, áti Muhammedenil vesílete, vel fadílete, veb'ath-hu mekámen mahmudenil-ledhi vead'tehu!* Përkthimi: O Allahu im, Zot i kësaj thirrjeje të plotë dhe i namazit që do të falet, jepi Muhamedit ndërmjetësimin dhe nderimin, ngrije atë në vendin e lavdishëm, të cilin ia ke premtuar. Transmeton Buhariu 1/152.

- Ndhimjoji njerëzit në ndërtimin e xhamive, në ato vende ku janë të nevojshme, si dhe përkrahi ata fizikisht dhe materialisht!
- Nderoju xhamitë dhe kur të hysh në to hy me këmbën e djathtë, mirëmbajti ato nga papastërtia, përmbajti rregullave të tyre, shmangu nga fjalët e kota në to, mos vrapo nëpër xhami, mos qeshni, mos bëni zhurmë, dhe kur të dilni nga xhamia dilni me këmbën e majtë!
- Mos pështyni në oborrin e xhamisë e as në drejtim të kibles, mirëpo pështyni në façoletë apo diçka të ngjashme me të. Gjënë e humbur mos e kërkoni në të, në formë nderimi ndaj xhamisë!
- Përmbajti faljes së namazit në kohën e caktuar, me xhemat në xhami, e veçmas namazin e jacisë dhe atë të sabahut!
- Mos e shtyni ndonjë namaz deri sa t'i dalë koha e vet!
- Mos falni namaz vullnetar pas sabahut e as pas ikindisë, përveç namazeve me arsye (si p.sh. namazi që falët për nder të xhamisë - *tehij-jetul mesxhid*)!
- Pas namazit të sabahut dhe atij të ikindisë, qëndroni aty ku jeni falur!¹²
- Insisto që gjatë kohës së lirë të qëndroni në xhami (të bëni I'tikaf) duke u angazhuar me adhurim ndaj Allahut!
- Mos hani ushqime që posedojnë erëra të pakëndshme, si: hudhra, qepë etj., si dhe mos e konsumoni duhanin, për arsye që mos t'i shqetësoni muslimanët!

¹²⁾ Natyrisht nëse keni mundësi dhe kohë të lirë. Të qëndruarit në atë vend ku e keni falur sabahun deri sa të lindë dielli duke bërë dhikër, duke përmendur Allahun dhe po ashtu pas ikindisë deri sa të perëndojë dielli gjithashtu duke bërë dhikër, jo vetëm që është sevap i madh, por edhe ndihmon në mobilizim kundër shejtanit gjatë ditës, përkatësisht gjatë natës. (Sh. P.)

- Urdhërojeni familjen tuaj me përkushtim në kryerjen e namazit, sepse namazi është shtylla më e rëndësishme e besimit islam!
- Bëji gratë e familjes suaj që të duan ta falin namazin në shtëpi!
- Urdhërojini fëmijët tuaj që ta falin namazin duke filluar nga mosha shtatë vjeçare, dhe në rast se ata e braktisin këtë obligim, atëherë rrihni ata kur të kenë mbushur dhjetë vjet! Mos e neglizhoni këtë gjë, sepse bëheni mëkatar!¹³
- Shpjegoji familjes suaj dhe njerëzve të tjerë se çfarë është thënë për vlerën e pesë kohëve të namazit, si dhe dënimin që do ta vuajë lënësi i namazit!
- Përpiqu t'i përmbahesh faljes së suneteve të namazit, qofshin para farzit apo pas tij, qofshin të forta apo të preferuara, aq sa të keni mundësi!
- Namazet nafîle (sunetet) fali në shtëpi!

¹³ Është obligim për prindërit dhe e drejtë e fëmijëve që të mësohen qysh në vegjëli ta falin namazin, ashtu siç mësohen për t'u ushqyer, veshmbathur etj. Kur fëmija e mbush moshën dhjetëvjeçare dhe përton të falet, duhet të përdoret edhe rrahja si masë edukuese vetëm e vetëm që namazi t'i mishërohet dhe të adaptohet me të, në mënyrë që kur të rritet, mos të ndihet i ngarkuar me namaz. Allahu thotë: *"O ju, që besoni! Ruajeni veten dhe familjet tuaja nga zjarri, lënda djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët."* (Et-Tahrim, 6) Pra, ashtu siç e ruani veten nga zjarri i xhehenemit, ruajeni edhe familjen tuaj ku bëjnë pjesë edhe fëmijët. Nëse për mospërfillje të ndonjë dëshire personale nga ana e fëmijës tuaj jeni në gjendje ta ndëshkoni dhe ta rrihni, a nuk meriton namazi dhe porosia e Allahut që fëmijës t'i sqarohet qysh nga mosha kur fillon t'i kuptojë gjërat, mosha shtatëvjeçare? Gjithsesi, në këtë çështje nuk duhet neglizhuar asnjë çast, në të kundërtën nuk e kemi kryer amanetin e pranuar mbi supet tona.

- Ji i rregullt në faljen e namazin të duhásë¹⁴, së paku dy rekate edhe pse më mirë do të ishte të falnit tetë rekate!
- Përpiqu që t'i këndosh lutjet pas namazeve të obliguara!
- Përgatitu për faljen e namazit të natës, duke qenë i përmbajtur ndaj kësaj bote, duke mos u ngopur dhe duke praktikuar gjumin pas drekës!
- Praktikoje këndimin e lutjeve (duave) para fjetjes dhe pasi të zgjoheni!
- Flini duke qenë të pastër me abdes, duke përmendur Allahun, si dhe me nijet për t'u ngritur në mesnatë për namaze të natës!
- Namazin e natës faleni rregullisht dhe mos harroni që për këtë namaz t'i zgjoni edhe gruan dhe fëmijët tuaj!
- Faleni namazin kur të ndodhë eklipsi i zënies së diellit dhe hënës!¹⁵
- Çdo muslimani falini namazin e xhenazes!

¹⁴ Ky namaz falet pas lindjes së diellit dhe kalimit të gjysmës së orës dhe zgjat deri para namazit të drekës. Rreth vlerës se këtij namazi kanë ardhur shumë hadithe, siç vijnë: I Dërguari i Allahut, alejhis-selam, thotë: *“Pendimtar i madh është ai që e falë namazin e duhasë.”*. (Transmeton Tabreaniu, hadithi është hasen), si dhe hadithe të tjera.

¹⁵ Me rastin e zënies së diellit dhe hënës, njëra prej tjetrës, është sunnet i fortë për meshkujt dhe femrat që të falet namazi i tyre “Salatul Kusuf” kur zihet dielli dhe “Salatul Husuf” kur zihet hëna. Këtë namaz e ka falur edhe i Dërguari i Allahut, alejhis-selam, kur ishte zënë dielli në kohën e tij. Ky lloj namazi falet me xhemat (në grup) dhe preferohet të fillohet atëherë kur fillon zënia e këtyre planeve dhe zgjat deri sa të kthjellat horizonti. Ai përbëhet prej dy rekateve, dhe sipas mendimit më të saktë, çdo rekat përmban nga dy ruku, ashtu siç përmban edhe nga dy sexhde. Pas këtij namazi preferohet të mbahet një hutbe nga i pari i muslimanëve të atij vendi. Ky namaz mund të falet edhe veçmas - jo me xhemat.

- Fale namazin e Istihares¹⁶ për çdo çështje të rëndësishme, si dhe këndojeni duanë përkatëse!
- Praktikoje faljen e namazit me xhemat!
- Bëhu i përpiktë në rreshtimin mirë të safave, mbushjen e tyre si dhe plotësimin e zbrazëtirave në mes tyre!
- Shpejto që namazin ta falësh në rendin (safin) e parë, duke mos e shtyrë asnjërin!
- Praktikoje rregullisht duanë hyrëse të namazit¹⁷; në përfundim të leximit të Fatihasë, thuaj pas imamit “Amin” si dhe lexoji lutjet e rukus dhe sexhdes!
- Kryeji me përkushtim rukutë, sexhdet, kthimin pas rukusë si dhe qëndrimin në mes të dy sexhdeve!
- Ki kujdes dhe mos kalo para atij që është duke u falur!
- Nëse falesh në një vend ku aty kalojnë njerëzit, atëherë vendos diçka para teje që të jetë sutre-pengesë mes teje dhe kaluesve!

¹⁶⁾ Namazi i istihares është një nga namazet vullnetare që është sunet të falet, kur muslimani është para ndonjë dileme dhe nuk e di se cilën alternativë të zgjedhë, nga dy e më tepër të mundshme për ta zgjidhë atë dilemë.

¹⁷⁾ Që njihet me: Subhaneken apo dua të tjera që i ka praktikuar i Dërguari i Allahut, alejhis-selam, në hyrje të namazit, pas tekbirit fillestar.

KËSHILLA RRETH NAMAZIT TË XHUMASË

- Nisuni sa më herët për ta falur xhumanë dhe kur të dëgjoni thirrjen e ezanit, përgjigjuni menjëherë!
- Pastrohuni vazhdimisht në ditën e premte (para namazit të xhumasë) si gjatë verës ashtu edhe gjatë dimrit!
- Prejini thonjtë dhe pastrohuni çdo javë, ngase Islami është fe e pastër!
- Ditën e xhuma parfumosuni me erëra të mira dhe vishni rrobat më të zgjedhura!
- Kini kujdes nga të shtyrit nëpër sáfa [radhët e xhamisë]!
- Mos folni përderisa imami është duke ligjëruar hutben e xhumasë!
- Sa të keni mundësi praktikojeni leximin e sures El-Kehf çdo të premte - të xhuma!
- Shtojini përshëndetjet [salavatet dhe selamet] mbi të Dërguarin, lavdërimi dhe paqja e Allahut qofshin mbi të, gjatë natës së xhuma dhe ditës së xhuma!¹⁸

¹⁸⁾ Në Islam, me të hyrë të namazit të akshamit, ajo natë konsiderohet nata e ditës së ardhshme e jo e së kaluarës. Kjo vlen për të gjitha netët e javës. Pra kur thuhet natën e xhumasë, duhet ta kemi parasysh se ajo fillon nga akshami i ditës së enjte dhe mbaron në namazin e sabahut, kurse dita e xhuma fillon në namazin e sabahut ditën e premte dhe zgjat deri në aksham të asaj dite. (Sh. P).

KËSHILLA RRETH SADAKASË - BAMIRËSISË

- Bëhuni xhymert dhe ruajuni nga koprracia, ngase Allahu i Madhërisëm është Bujar dhe i do dorëdhënësit!
- Paguaje zekatin për të cilin jeni të obliguar dhe mos u bëni koprracë ndaj atyre që e meritojnë marrjen e asaj sasi!
- Nëse ju godet ndonjë skamje apo varfëri, lidheni atë me Allahun e Madhërisëm, dhe assesi mos lejoni që me zemrën tuaj t'i mbështeteni dikujt prej krijesave!
- Ajo që ju ofrohet nga dikush si dhuratë dhe e vëreni se nuk e ka bërë me plot zemër, atëherë mos e pranoni!
- Mësohu që dhënia e lëmoshës (sadakasë) të jetë shprehje e vazhdueshme në jetën tënde dhe asgjë mos e nënvlerëso nga sadakaja!
- Jepni sadaka nga ajo që është më e dashur nga pasuria juaj, siç na porositi edhe Allahu i Madhërisëm: **“Nuk keni për ta arritur përkushtimin e vërtetë, derisa të ndani (lëmoshë) nga ajo (pasuria) që e doni.”**¹⁹
- Lëmoshën vullnetare jepeni fshehurazi, kurse zekatin jepeni në praninë e masës, në mënyrë që të tjerët të marrim mësim nga ju!

¹⁹) Ali-Imran, 92.

- Gjatë dhënies se lëmoshës jepi përparësi të afërmve nga familja juaj si dhe njerëzve të mirë dhe fetarë!²⁰
- Të gjithë nevojtarëve të sinqertë, që kanë kërkuar hua nga ju, përgjigjuni pozitivisht!
- Atyre që ju kanë borxh, shtyja afatin e pagesës, e nëse nuk janë në gjendje që ta paguajnë atë, atëherë lirojini nga një pjesë e borxhit!
- Jepni për destinacione të mira, si p.sh. ndërtimin e xhamive, përhapjen e diturisë dhe shkencave, sepse këto hynë në rangun e lëmoshës së rrjedhshme!²¹
- Edhe bashkëshortes sate lejoji që të japë lëmoshë nga pasuria juaj!
- Paralajmërojeni gruan tuaj që mos të japë asgjë lëmoshë nga ajo që nuk ia ke lejuar!
- Ushqeni dhe jepini ujë të tjerëve dhe mos e përçmoni asgjë nga veprat e mira!
- Falënderojeni personin që ju ka bërë mirë dhe shpërblejeni atë, si dhe lutuni për të që Allahu t'i japë të mira!

20) Nga kjo këshillë mësojmë shumë urtësi, për të cilat kemi shumë nevojë. Kur t'u japim lëmoshë të afërmve tanë, pa dyshim se ky gjest human forcon edhe më shumë lidhjet familjare si dhe është më e lehtë për ne që t'u besojmë ndonjë amanet të afërmve se sa atyre që nuk i njohim fare. Prandaj, dhënia e lëmoshës apo zekatit është mirë që në rend të parë t'u jepet atyre që i kemi të afërm nga gjaku, mirëpo nëse na mundësohen kushtet materiale, atëherë edhe nëse u japim të tjerëve, për këtë Allahu prapë do të na shpërblejë. Në lidhje me këtë, Allahu i Madhërishëm thotë: "...Çfarëdo që të jepni (për Zotin), Allahu e di atë." (Ali-Imran, 92) (Sh. P.)

21) Shpërblimi për këtë lloj lëmoshe nuk ndalet edhe pas vdekjes së dhënësit. (Sh. P.)

KËSHILLA RRETH AGJËRIMIT

- Agjëroni gjatë muajit të Ramazanit për Allahun e Madhërishtëm, me besim të plotë dhe duke shpresuar bindshëm në shpërblimet e Tij!
- Ke kujdes që mos të hani në asnjë ditë të Ramazanit pa pasur arsye të justifikuar!
- Gjatë muajit të Ramazanit falni namaze nate, veçanërisht gjatë Natës së Kadrit!
- Agjëroni gjashtë ditë nga muaji Shevval!
- Agjëroni ditën e nëntë dhe të dhjetë të muajit Muharrem - ditët e ashures!
- Agjëroni nga muaji Sha'ban aq sa keni mundësi!²²
- Agjëroni ditët e hëna dhe të enjte!
- Agjëroni ditët e bardha nga çdo muaj! Ato janë: dita e trembëdhjetë, e katërbëdhjetë dhe pesëmbëdhjetë!
- Informojeni bashkëshorten tuaj që mos të agjërojë vullnetarisht pa lejen tuaj kur ju jeni prezent!
- Vonojeni ngrënien e syfyrit, kurse ngrënien e iftarit fillojeni me të hyrë koha, përveç kur mbretëron koha e vranët!

²²) Për vlerën e muajit Sha'ban flet edhe hadithi i të Dërguarit, të cilin e transmeton Nesaiu nga Usame Bin Zejd, ku thotë: *I thashë: O i Dërguari i Allahut! Nuk të kam parë të kesh agjëruar në muajt e tjerë siç po të shoh në muajin Sha'ban. Ai tha: Ai është një muaj, në mes Rexhepit dhe Ramazanit, që njerëzit e anashkalojnë, në këtë muaj ngrihen veprat tek Krijuesi i botëve, andaj unë kam dëshirë që vepra ime të ngrahet duke agjëruar.* (Sh.P)

- Fillojeni iftarin me hurma të njoma ose të thata, e nëse nuk gjeni, atëherë me ujë!
- Kujdesuni që ushqimi të cilin e hani për iftar dhe syfyf të jetë nga pasuria hallall!
- Ftoni agjërues që të hanë iftar në shtëpinë tuaj, sepse Ramazani është muaji i bujarisë!
- Përmbajuni normave të agjërimit; mos përgojoni, mos gënjeni dhe mos folni fjalë të ndyta!
- Përpiquni që mos ta braktisni I'tikafin në dhjetë ditët e fundit të Ramazanit!
- Paguani fitrat (sadakatulfitrin) që zemra juaj të jetë e kënaqur me këtë veprim!
- Netët e të dy bajrameve gjallërojini duke falur namaz dhe duke bërë mënyra të tjera të adhurimit!
- Në festën e dy bajrameve dhe ditëve te teshrikut²³ shqip-toni tekbiret me zë të lartë!
- Po patët mundësi materiale, therjen e kurbanin përpiquni ta praktikoni çdo vit!
- Nga therja e kurbanit mos shitni asgjë, e as therësin (kasapin) mos e paguani nga mishi i kurbanit!

²³⁾ Ditët e Teshrikut (Ejjamut-teshrik), janë tri ditë të cilat pasojnë pas ditës së Kurban Bajramit. Këto ditë janë: dita e njëmbëdhjetë, e dymbëdhjetë dhe e trembëdhjetë e muajit Dhulhixheh. Këto ditë janë ditë gëzimi, dëfrimi dhe adhurimi ndaj Allahut, siç na mëson i Dërguari, lavdërimi dhe paqja e Allahut qofshin mbi të! (Sh. P.)

KËSHILLA RRETH HAXHILLËKUT

- Haxhillëkun²⁴ dhe Umren²⁵, nëse keni mundësi, nxitoni t'i kryeni menjëherë, dhe keni kujdes nga vonesa! Orvatuni që t'i bëni ato qoftë edhe në çdo pesë vjet!

²⁴) Haxhillëku është riti fetar dhe njëkohësisht shtylla e pestë e Islamit, që është obligim për çdo musliman në moshë të rritur, që është i shëndoshë psikikisht, i pasur materialisht, duke pasur rrugën e lirë dhe të sigurt. Për femrën kërkohet edhe përcjellja e bashkëshortit apo e ndonjë mashkulli me të cilin i ndalohet martesja, si vëllai, babai, xhaxhai etj. Haxhillëku daton qysh nga koha e Ibrahimit, alejhis selam, dhe është obligim i këtij ummeti. Bëhet në kohë të paraparë (në muajt X, XI dhe XII të kalendarit hënor) dhe në vend të caktuar (në Mekë dhe rrethinën e saj). Haxhillëku është kongresi vjetor islam, që i tubon muslimanët nga e tërë bota, që synojnë vizitën e Qabesë dhe kryerjen e këtij obligimi islam. Është obligim të kryhet një herë gjatë jetës. Përmbushja e këtij riti, muslimanit i shlyen mëkatet e mëhershme. (Sh. P.)

²⁵) Umreja është vizita e Qabesë me ceremonitë e parapara, që kryhet jashtë kohës së haxhillëkut dhe bëhet në mënyrë vullnetare. Ka shpërblim të madh për muslimanin, që e bën një vizitë të Qabesë në çdo kohë, por më e çmueshmja do të ishte Umreja gjatë muajit Ramazan. Disa dijetarë mendojnë se edhe umreja është obligim të bëhet një herë gjatë jetës, dhe ajo mund të bëhet gjatë të njëjtit udhëtim kur shkon për të kryer edhe haxhillëkun. Disa të tjerë mendojnë se Umreja është e preferuar, jo e obliguar. Ceremonitë e Umres janë shumë më të pakta dhe nuk lidhen me kohën, as gjatë ditës e as gjatë vitit. (Sh. P.)

- Gjatë udhëtimit për haxhillëk, shoqërohuni me hoxhallarë, në mënyrë që të udhëzojnë për kryerjen e saktë të ritualeve të haxhillëkut!
- Paraprijni haxhillëkut me pendim të sinqertë dhe kryeji sekuencat e tij para nisjes për në haxhillëk!
- Gjatë rrugës fatlume për në haxhillëk, jepni lëmosha sa më shumë duke ndihmuar njerëzit!
- Keni kujdes që paratë e haxhillëkut të mos jenë nga malli haram!
- Umren kryejeni gjatë muajit të Ramazanit!
- (Gjatë kohës kur jeni në haxhillëk) Tekbiret thuaji me zë të lartë!
- Gjatë vizitave të Qabesë, shpeshtojeni Tavafin (të ecurit) rreth Qabesë, putheni gurin e zi²⁶ si dhe këndin jemenas të Qabesë, apo vetëm përshëndetini me dorë nga larg!
- Ruaju nga turmat e njerëzve, në mënyrë që të mos e lëndoni askënd dhe të mos lëndoheni nga askush!
- Ngopuni me ujin e Zemzemit, duke pirë ujë të shumtë të tij!
- Shumoji veprat e mira gjatë dhjetë ditëve të muajit Dhulhixhe!
- Përgatituni për qëndrimin në Arafat, duke pastruar brenëdinë tënde nga të gjitha urrejtjet dhe plagët shpirtërore!
- Shpejtoni që gjuajtjen e guralecëve dhe të gjitha ceremonitë e tjera të haxhillëkut t'i kryeni sapo të hyjë koha e tyre!
- Mos lejo që gratë e tua (bashkëshortja, vajza, motra, nëna etj.) të marrin rrugën për haxhillëk apo për vende të tjera, pa praninë e bashkëshortit apo ndonjë të afërmi të tyre (mahrem)!

²⁶⁾ El-Haxheru-l-Esved.

- Fali namazet sa më shumë në Xhaminë e Mekës (Qabe), në Xhaminë e Medinës dhe në Mesxhidul Aksa!
- Mos e fyej askënd nga banorët e Mekës dhe Medinës, e as mos i përçmo për nder të fqinjësisë së tyre me këto vende të bekuara!
- Kur të ktheheni nga ndonjë udhëtim, mos hy në shtëpi befas, ose gjatë natës, pa paralajmërimin e anëtarëve të familjes!

KËSHILLA RRETH LUFTËS SË SHENJTË - XHIHADIT

- Bëhu trim e mos u frikëso, sepse i Dërguari i Allahut, alejhi selam, ka kërkuar mbrojtje tek Allahu i Madhërishëm nga frika!
- Mos u nis për luftë pa marrë pëlqimin e prindërve!
- Nëse të është dhënë rasti të luftosh në rrugë të Allahut, atëherë qëndro fuqishëm në pozicionin e muslimanëve!
- Kërko nga Allahu që të biesh shhid²⁷ (martir) në rrugën e Tij, i Madhëruar qoftë!

²⁷) Synim madhor i luftëtarit do të ishte arritja e fitores në luftë. Por duke e ditur se Allahu i Madhërishëm e veçon së nderuari shehidin, i cili e flizon jetën e tij për në rrugën e Allahut, muslimani ka lakmi më të madhe që të bie shhid se sa t'i gëzohet fitores, sepse me fitoren e luftës arrin të mira në këtë botë, të cilat janë jetëshkurtra dhe të kufizuara, kurse me rënien shhid arrin të mirat e ahiretit, të cilat janë të amshueshme dhe të pakrahasueshme.

Për vlerën e shehidit ka shumë hadithe të sakta që i saktësojnë favorret e tij, prandaj po përmendim vetëm disa favore për të: me derdhjen e pikës së parë të gjakut i falen të gjitha mëkatet përveç borxhit, e sheh vendin e tij në Xhenet para se t'i dalë shpirti, zgjerimi i varrit për të dhe mos-dënimi në varr, ndërmjetëson për familjarët e tij, nuk e ndien trishtimin e Ditës së Kijametit dhe gjendjen e rëndë para llogarisë, plaga e tij e ka ngjyrën e gjakut Ditën e Gjykimit, kurse era e gjakut të tij ka erë parfumi, hyn në Xhenet etj. Po e përfundoj me hadithin e Enes Ibën Malikut, që i Dërguari i Allahut, alejhis-selam, e përshkruan shumë fuqishëm vlerën e rënies shhid, ku thotë: *“Askush nga ata që hynë në Xhenet nuk dëshiron të kthehet në*

- Derisa të jesh në luftë, përpigu të veprosh sa më shumë punë të mira; agjëro vullnetarisht, përmende Allahun duke thënë Subhanallah!, Elhamdulillah, Allahu Ekber etj., dhe mbi të gjitha; nëse ke borxh, paguaje sa më shpejt, sepse mëkati i moslarjes së borxhit nuk i falet madje as shehidit!
- Doemos duhet të mësosh gjuajtjen dhe përdorimin e të gjitha mjeteve të luftës dhe ke kujdes që mos t'i braktisësh pasi të kesh mësuar përdorimin e tyre!
- Mos merr në shënjestër ndonjë krijesë të gjallë për ta gjuajtur!
- Pastroje qëllimin para nisjes për në luftë; mos tolero që synimi i shkuarjes në luftë të jetë lakmia për plaçkën e luftës, apo arritja e famës si guximtar apo i zellshëm!²⁸

dynja, edhe po t'ia japësh të gjithë tokën dhe çfarë ka në të, përveç shehidit, i cili ka iluzion të kthehet në dynja e të vritet dhjetë herë, për shkak të nderimit që ka përjetuar kur ka rënë shehid.” (E shënojnë Buhariu dhe Muslimi, sh. p.)

28) Qëllimi i pjesëmarrjes në luftë duhet të jetë krejtësisht i pastër, në mënyrë që të arrihet grada e shehidit, e cekur më parë, nëse bie i vdekur gjatë luftimit. Motivet që e lëvizin njeriun për luftë mund të jenë të ndryshme. Dijetarët kanë cekur se ato kufizohen në gjashtë: për t'u pasuruar, për të arritur famë, nga syefaqsia, nga fanatizmi, dhe nga mllefi individual. Të pesë këto motive janë të papranuara për ta pastruar qëllimin për luftë, dhe mbetet i gjashti dhe i vetmi që Allahu e pranon. Ai motiv shihet qartë në këtë hadith: Transmeton Ebu Musa se një njeri kishte ardhur tek i Dërguari i Allahut, alejhisselam, dhe e kishte pyetur: “Nëse një njeri lufton për hir të pasurimit, ndërsa tjetri lufton për hir të autoritetit, kurse tjetri për hir të dukjes se po merr pjesë (në disa transmetime përmenden edhe motivi i fanatizmit dhe ai i mllefit personal), cili prej tyre është në rrugën e Allahut?” I Dërguari [alejhisselam] u përgjigj: “Kush lufton për hir që fjala e Allahut të jetë më e larta, ai është në rrugën e Allahut.” (Shënon Buhariu dhe Muslimi)

- Ruaju që mos të ikësh nga fronti i luftës, për arsye se ikja nga mejdani i luftës llogaritet prej mëkateve më të mëdha!
- Mos merr nga plaçka e luftës (ajo që është zënë nga lufta) para se ajo të ndahet në mënyrë të drejtë nga kompetentët!
- Në qoftë se nuk të është dhënë rasti të luftosh në mënyrë reale, atëherë foli vetes rreth luftës, në mënyrë që mos të vdesësh me një pjesë të hipokrizisë!

Pastaj po e përmendi hadithi tjetër, që është kërcënues për kategoritë e luftëtarëve që motivohen për luftë për qëllime të tjera, e sidomos ai që e synon autoritetin e trimërisë, me të cilin rrezikon ta prishë rendin në shoqëri: *“Nga njerëzit e parë që do të gjykoen Ditën e Gjykimit është njeriu, i cili ka vdekur në luftë. Sillet para Allahut dhe njoftohet me mirësitë e tij dhe i njeh ato. I thuhet: “Çka ke bërë me to?” Thotë: “Kam luftuar për hir Tënde derisa kam ra shehid.” Allahu i thotë: “Po rren, se ke luftuar për tu thënë se je trim dhe të është thënë”. Pastaj urdhëron që të tërhiqet zhargas në fytyrë dhe hedhet në zjarr...”* (Shënon Muslimi dhe Nesaiu) Sh. P.

KËSHILLA RRETH LEXIMIT TË KUR'ANIT

- Mësoi fëmijëve dhe bashkëshortes tënde leximin e Kur'anit dhe urdhëroji që edhe ata t'ua mësojnë atë të tjerëve!
- Bëje zakon që Kur'anin ta lexosh ngadalë dhe zbukuroje zërin gjatë leximit të tij!
- Kur'anin lexoje duke medituuar kuptimet e tij; zbatoji urdhrat që janë në të dhe largohu nga ndalesat e tij!

KËSHILLA RRETH TË PËRMENDURIT TË ALLAHUT (DHIKRIT) DHE LUTJEVE (DUAVE)

- Shpeshtoje përmendjen e Allahun (dhikrin duke thënë Subhanallah, Elhamdulillah, Allahu Ekber, La ilahe il-lallah etj.) vazhdimisht, në vete dhe me zë dhe ruaju nga pavëmendja, duke harruar që ta përmendësh Allahun!
- Prezanto në tubimet e dhikrit (aty ku përmendet Allahu), ngase ato llogariten prej kopshteve të Xhenetit!
- Kurrsesi mos merr pjesë në ato tubime ku nuk përmendet Allahu, e as nuk shprehen salavate ndaj të Dërguarit [alejhis-salatu ves-selam]!
- Kur të ngriheni nga ndonjë tubim apo mbledhje, këndonit lutjen në vijim: “*Subhânekell-llahumme ve bihamdike, Esh-hedu En Lá Iláhe Il-la Ente, Estagfiruke, ve Etúbu ilejke*” (O Allah, Ti je i patëmeta. Ty të takon falënderimi. Dëshmoj se nuk ka hyjni që meriton adhurimin me të drejtë, përveç Teje. Të kërkoj falje dhe tek Ti kthehem)!
- Përkushtohu ndaj dhikrit - të përmendurit respektiv - të Allahut pas çdo namazi²⁹!

²⁹) Duke lexuar *Estagfirullah* tri herë dhe *Allahumme entes selam ve minkes selam...*, pastaj Ajetul Kursinë, suret El-Ihlas, El-Felek dhe En-Nas, 33 herë *Subhanallah*, 33 herë *Elhamdulillah-lah*, 33 herë *Allahu Ekber* etj. (Sh. P.)

- Lute³⁰ Allahun kur jeni në sexhde, pas çdo namazi dhe në pjesën e tretë të natës!³¹
- Përmende Allahun në vende të pavëmendjes, në vende ku më së paku përmendet emri i Tij, siç janë tregjet, vendet e biznesit, e të ngjashme me to!
- Nga Allahu kërko që t'i falë mëkatet, ta ruajë fenë dhe besimin tënd, të të japë shëndet të mirë në këtë botë dhe të të ruajë nga zjarri në ahiret!
- Ki mendim të mirë për Allahun e Madhërisëm dhe mos u dëshpëro nëse përgjigja e Allahut të vonohet, por çdo gjë dorëzoja Atij, i Madhëruar qoftë!

³⁰⁾ Duaja apo lutja është mënyra lidhëse në mes robit dhe Zotit të tij, ajo që e lidh muslimanin me Krijuesin. Allahu i Lartësuar thotë: *“Zoti juaj ka thënë: “Më thirrni Mua, Unë ju përgjigjem...”* (Gafir, 60) Allahu e ka kushtëzuar përgjigjen që vjen nga Ai me kërkesën që bëhet nga ana e robit. Këtë e vërteton hadithi i Pejgamberit, alejhi selam, se *“Duaja (lutja) është adhurim”*. Transmeton Tirmidhiu 2370. (Sh. P.)

³¹⁾ Namazi i natës fillon me të falur të namazit të jacisë dhe zgjat deri kur të hyjë koha e namazit të sabahut. *“Namazi i natës është rruga e njerëzve të mirë që ishin para jush, të afron te Allahu i Lartësuar, t'i shlyen mëkatet, të largon nga e keqja, ta largon sëmundjen nga trupi.”* (Sahih, transmeton Ahmedi dhe Tirmidhiu).

Shpërblimet e këtij namazi janë të panumërta e sidomos kur ky namaz falet në pjesën e thellë të natës, në veçanti gjatë 1/3 së fundit të natës. Është adresa e njerëzve të devotshëm. Ky namaz është të vetmohesh me Allahun dhe të bën ta ndiesh ngrohtësinë e lidhshmërisë me Krijuesin e gjithësisë. Allahu ndryshe këta njerëz i quan edhe dijetarë ku thotë: *“A mund të krahasohet ai që falet natën, duke bërë sexhde dhe duke qëndruar në këmbë e që ruhet prej jetës tjetër dhe shpreson në mëshirën e Zotit të tij (me jobsimtarin)?! Thuaj: “A janë të barabartë ata që dinë dhe ata që nuk dinë?! Vetëm të mençurit i pranojnë këshillat!”* (Zumer, 9) (Sh. P.)

- Bëj du'a duke qenë i koncentruar me zemër dhe duke ia pasur frikën Atij dhe mos iu lut me zemër të papërqendruar!
- Gjatë lutjeve këndoni du'atë (lutjet), të cilat janë nëpër tekstet kur'anore dhe thëniet profetike, sepse ato janë më të vlefshme!
- Lutjen filloje me falënderim ndaj Allahut dhe me përshëndetje [salavate] mbi të Dërguarin e Allahut [alejhis-salatu ves-selam], dhe më pas përfundoje me të, para se të thuash Amin!
- Lutu për vëllanë tënd fshehurazi dhe kërko nga ai që të lutet për ty. Asnjëherë mos u lut kundër vëllait musliman!
- Kërko falje nga Allahu (bëj istigfar) gjatë natës, e sidomos para kohës së agimit!
- Dërgo sa më shumë salavate mbi të Dërguarin e Allahut [alejhis-salatu ves-selam], veçmas në vigjilje të (natën e) së premtës dhe gjatë ditës së saj!

KËSHILLA RRETH SHITBLERJES

- Shpejto që t'i sigurosh mjetet e jetesës dhe ruaju nga papunësia dhe përtacia!
- Korrigjoji shitblerjet e tua në përputhje me ligjin e Allahut dhe nga shitblerjet e paligjshme!
- Ke kujdes nga shitblerja e mallrave të ndaluar (haram) dhe nga transaksionet kamatare!³²

³²⁾ Është e vërtetë e hidhur se në ditët e sotme shohim biznese të ndryshme, të cilat nuk përkojnë fare me mësimet dhe normat e shëndosha islame. Ndoshta për disa, dikur shitblerja e alkoolit konsiderohej diçka e thjeshtë, ndërsa tashmë në tregun tonë ajo është bërë e përditshme, saqë këta biznesmenë duke parë të ardhurat mujore nga ky biznes, kanë harruar se blerësit e tyre do të kërkojnë nga ta edhe gjëra të tjera. Ajo që na trondit të gjithëve është se, lakmia është gjëja më e keqe që njeriun e shkatërron për një kohë të shkurtër. E them këtë për faktin se njerëzit e tillë nuk u mjaftuan vetëm me alkool, por ata më vonë filluan të hapin lojërat e fatit, bastoret, klubet e natës, çfarë është me e keqja, në trojet tona shqiptare, filloi edhe shitblerja e drogës, të cilën po e pason prostitucioni, armët, kamata etj. Përse e gjithë kjo? Ky është rezultat i mospërfilljes së fjalëve të Allahut. Allahu i Madhëruar na e ka tërhequr vërejtjen nga llojet e tilla të bizneseve duke thënë në ajetin kur'anor: *“O ju që besuat, s’ka dyshim se vera, bixhozi, idhujt dhe hedhja e shigjetës (për fall) janë vepra të ndyta nga shejtani. Pra, largohuni prej tyre që të jeni të shpëtuar. Shejtani nuk dëshiron asgjë tjetër, përveç se nëpërmjet verës dhe bixhozit të hedhë armiqësi mes jush, t’ju pengojë nga të përmendurit e Zotit dhe t’ju largojë nga namazi. Pra, a po i jepni fund (alkoolit e bixhozit)?* (El-Maide, 90-91) (Sh. P.)

- Mos e lavdëro mallin që ke në pronësi dhe mos ia imponi blerësit mendimin tuaj, por lëre të mendojë lirshëm!
- Largohu nga gjërat e dyshimta!³³
- Bëhu zemërgjerë përgjatë blerjes dhe shitjes; trego sjellje të mira gjatë kërkimit të hakut tënd dhe gjatë pagesës kur ti blen!
- Po qe se blerësi është penduar për mallin që ka blerë nga ju, ktheja të hollat dhe pranoja pendimin. Padyshim se Allahu i Gjithëmëshirshëm do t'ia falë gabimin atij që e pranon mallin e kthyer, në Ditën e Llogarisë!
- Bëhu preciz gjatë matjes së mallit dhe mos ia ha hakun blerësit!
- Këshillo gjatë shitblerjes dhe në raste të tjera dhe ruaju nga mashtrimi!
- Mos i ndërhy në pazar vëllait tënd musliman derisa ai të tërhiqet nga oferta dhe mos u fejo me atë vajzë e cila është fejuar apo është në proces të fejesës!³⁴

³³⁾ Gjatë shitblerjes, muslimani mund të bie në situata të ndryshme, kur nuk është i sigurt se veprimi i tij i takon gjërave të lejuara apo atyre të ndaluara. Ato raste do t'i numëronim si gjëra të dyshimta. Nëse bindja për ndalesë është e dobët, por edhe bindja për lejim nuk është e plotë, atëherë është më mirë t'i ikim gjërave të dyshimta. I Dërguari i Allahut, lavdërimi dhe paqja e Allahut qofshin mbi të, ka thënë: *"E lejuara (hallalli) është e qartë, por edhe e ndaluara (harami) është e qartë. Ndërmjet tyre janë disa gjëra të dyshimta, të cilat shumë njerëz nuk i dinë. Kush mbrohet nga gjërat e dyshimta, e ka siguruar besimin dhe nderin e tij, ndërsa kush bie në gjërat e dyshimta, ka rënë në të ndaluarën."* (Transmeton Buhariu dhe Muslimi)

Po ashtu i Dërguari i Allahut ka thënë: *"Largohuni nga ajo që ju vë në dilemë dhe konctrohuni në atë që nuk ju vë në dilemë!"* (Transmeton Tirmidhiu) (Sh. P.)

- Ruaju nga monopolizimi i mallit (grumbullimi i mallrave me qëllim të shitjes me çmim më të lartë në kohët e vështira)!³⁵
- Bëhuni të sinqertë në punët që realizoni dhe ruajuni nga gënjeshtria dhe betimi i rrejshëm!³⁶

³⁴) Kjo këshillë është shumë me rëndësi për muslimanët kudo që janë, e veçmas për vëllezërit tanë shqiptarë, të cilët nëse ke pas rastin t' i shikosh se si tregtojnë nëpër tregje, do ta shohësh se nëse dikush dëshiron të blejë një lopë, apo veturë, do të vjen tjetri dhe ndërhy, duke thënë se unë po e blej, apo ë bën që une ta marr me këtë çmim? Një gjë e tillë është e ndaluar juridikisht. Islami na mëson që kur të mbaron diskutimi rreth çmimit, atëherë mund të ndërhysh dhe të blesh mallin në fjalë. E njëjta gjë vlen edhe për një vajzë e cila është në prag të fejesës apo është fejuar. Nëse vajza është fejuar dhe ti shkon dhe fejon, atëherë një gjë e tillë është haram. (Sh.P.)

³⁵) Autori na tërheq vërejtjen që te largohemi nga përfitimet e tilla, siç ndodh në kohërat e vështira ku shumë tregtarë dhe biznesmenë, grumbullojnë mallrat e listës esenciale dhe gjërat që janë shumë të rëndësishme për jetën e njeriut, fjala vjen: mielli, vaji, karburantet, të gjitha këto njeriu gjatë luftës ka shumë nevojë që t' i posedojë. Mirëpo, për fat të keq që kur këto ndodhin, çmimet e tyre ngriten aq lart, saqë shumë shpejt këta njerëz bëhen trefish më të pasur nga çmimet marramendëse. (Sh.P.)

³⁶) Shumë tregtarë të cilët nuk i kanë frikën Allahut janë në gjendje që për të arritur sukses në biznesin e tyre të gënjejnë dhe të betohen rrejshëm, duke thënë: "Pasha Zotin lopa është e mirë" apo, "Betohem në Allahun që vetura është shumë e mirë dhe nuk ka me këtë veturë." Betimi nuk është gjë e lavdëruar edhe në situata të rëndomta, kur mund të jesh i sinqertë dhe i drejtë, ndërsa shumë tregtarë mundohen që mallin ta zbukurojnë me betime të rrejshme e jo me kualitete më cilësi dhe veprim. I Dërguari, lavdërimi dhe paqja e Allahut qofshin mbi, të ka thënë: "*Betimi e shet ndoshta mallin, por e humb bereqetin.*" (transmeton Buhariu, Ebu Davudi etj.) (Sh.P.)

- Bëhuni të besueshëm dhe ruajuni nga mashtrimet, pasi Pejgamberi i Allahut (alejhi selam), transmetohet se në lidhje me këtë ka thënë: *“Kryeja amanetin me përpikëri atij që të ka besuar dhe mos e tradhto atë që të ka tradhtuar!”*³⁷
- Mos e bë shprehi të marrësh borxh, mirëpo nëse huazon, atëherë ta kesh qëllimin që sa më shpejt ta lashë borxhin!
- Mos e vono borxhin kur ke mundësi të paguash, ngase vonesa në këtë rast konsiderohet padrejtësi (zullum)!
- Shpejto që personit që ka ndërruar jetë, të cilit ia do të mirën, t’ia paguash borxhet!
- Ruaju betimit të rrejshëm e të qëllimshëm!
- Ruaju nga kamata (interesi, fajdeja), uzurpimi, vjedhja, plaçkitja dhe mashtrimi!
- Asgjë mos merr nga pasuria e tjetrit pa lejen e tij, qoftë edhe përkohësisht!
- Nëpunësin (argatin) paguaje sa më parë, bile para se t’i jenë tharë djersët!
- Mos shkatërro duke shpenzuar nga pasuria pa pasur ndonjë qëllim të arsyeshëm!

³⁷ Hadithin e transmeton Ebu Davudi, Tirmidhiu etj. Albani thotë se hadithi është i saktë – sahih. (Sh.P.)

KËSHILLA RRETH BASHKËSHORTËSISË (NIKAHUT)

- Ule shikimin tënd dhe mos shiko pa kontroll, sepse shikimi është shigjetë helmuese!
- Kur të jesh në rrugë, mos hyj në mes të dy grave, por ec në anën e djathtë apo të majtë!
- Martohu sa më shpejt, ngase ai që martohet është më optimal që ta ruajë shikimin dhe nderin e tij!
- Kur të vijë koha për martesë, zgjedh gruan besimtare dhe të devotshme!³⁸
- Mos kërkohet divorcin, sepse ai, shkurorezimi, është prej gjërave të lejuara, të cilën Allahu e urren më shumë!
- Tërhiqja vërejtjen grave, vajzave dhe të afërmeve tuaja, që mos të kërkojnë divorc nga burrat e tyre, pa pasur ndonjë arsye të fortë!
- Mos e mëso gjuhën tënde duke iu drejtuar gruas me betim për shkurorezim!³⁹

³⁸) Pejgamberi, alejhi selam, ka thënë: “Motivet për të cilat zgjidhet për martesë një femër janë katër: pasuria e saj, përkatësia e saj familjare, bukuria e saj dhe feja e saj. Gjeneri atë me fe, përndryshe t’u thafshin duart! (Transmeton Buhariu, Muslimi dhe të tjerët) (Sh. P.)

³⁹) Betimi për divorc ka si qëllim që burri për çdo gjë ta kushtëzojë gruan e tij duke i thënë: ose bëje këtë, ose do të të ndajë. Pra, autori porositi që mos të bëhet zgjidhja e martesës temë që përflitet kohë pas kohe dhe të lidhen të gjitha kërkesat e burrit me zgjidhjen e martesës, divorcin. (Sh. P.)

- Në pamundësi të martesës përmbaje nderin tënd, derisa Allahu të të begatojë me dhuntitë e Tij dhe forcohu me agjërim!
- Nëse ty si prind të vjen dhe të kërkon dorën e vajzës ai që ju kënaqë me fenë dhe moralin e tij, atëherë martojeni vajzën me të dhe largojuni mehrit të shtrenjtë!⁴⁰
- Shpalle kurorëzimin dhe bëni dasmë me aq sa të mundeni!
- Mos toleroni që as fejesën e as dasmën ta kremtoni me gjëra të ndaluara, siç janë përdorimi i veglave muzikore, dëfrimit, zbavitjes etj.!
- Bashkëshortes tënde paguaja hakun e saj të merituar, “mehrin – dhuratën e martesës”, përfillini obligimet që ke- ni ndaj saj, dhe silluni me të me sjellje të mira!
- Njiheni bashkëshorten tuaj me obligimet martesore, të cilat duhet t’i kryejë në mënyrë të vazhdueshme!
- Mos bëni marrëdhënie intime me gruan tuaj kur ajo është në të përmuajshmet apo lehonë (me hajz apo nifas)!

⁴⁰) Martesa kohëve të fundit është bërë një ndër problemet më të rëndësishme që ka nevojë për t’u shëruar nga shumë aspekte. Shumë të rinj mendojnë se bashkëjetesa është më e lehtë dhe me më pak përgjegjësi se sa martesa, duke mos e ditur se ajo është e ndaluar në fenë islame. Ndërsa martesa e cila bënë ndërtimin e familjes dhe qetësimin fizik dhe shpirtëror të çiftit, në të ka edhe të mira në këtë botë dhe në botën e ardhshme. Mehri apo dhurata që i jepet femrës në të holla, nuk duhet të jetë një sasi shumë e madhe, pasi në shumë vende islame, mehri konsiderohet një vështirësi e pakapërcyeshme. Shumë të rinj vuajnë për arsye se atë mehër që kërkon vajza, është tejet i madh dhe si e tillë, martesa nuk mund të realizohet. E tërë kjo nuk është paralele me mësimet islame, ngase në fenë islame, sa më pak mehër që burri i jep gruas, aq më e bereqetshme do të jetë edhe jeta martesore. (Sh. P.)

- Mësojini grave tuaja dispozitat dhe normat e fesë islame dhe mos lejoni që ato të praktikojnë ndonjë gjë të kotë dhe besëtytni!
- Nëse jeni martuar njëkohësisht me më shumë se një grua, atëherë bëhuni i drejtë në ndarjen e kohës me to. Ruajuni nga zullumi - padrejtësia!
- Kujdesu për gruan dhe fëmijët e tu dhe kini kujdes nga koprracia!
- Kini kujdes që mos ta humbisni askënd nga ata që i keni nën kujdesin tuaj!
- Emërtojini fëmijën tuaj me emër të mirë!
- Mos i favorizoni meshkujt mbi vajzat!
- Kur është në pyetje dhurata, përpiquni që mes fëmijëve të krijoni një ambient barazie dhe uniteti!
- Edukoni fëmijët tuaj dhe kur të arrijnë t'i dallojnë gjërat⁴¹ detyrojeni që t'i praktikojnë normat bazë të fesë islame, në mënyrë që të mësohen me to! Gjithashtu në atë moshë fëmijët ndajeni secilin në shtratin e vet!
- Unifikohuni me bashkëshorten për metodologjinë që do të ndiqni rreth edukimit të fëmijëve, për shkak se mos-pajtimet e prindërve ndikojnë negativisht në edukimin e tyre!
- Martojini fëmijët kur të arrijnë moshën e pjekurisë!
- Ruajuni dhe assesi mos u bëni shkaktar që t'i prishni marrëdhëniet e dy bashkëshortëve, dy ortakëve dhe dy të dashuruarve!
- Gratë e tua urdhëroi që të mbulohen tërësisht sipas normave që ka paraparë (obliguar) Islami, për ta ruajtur nde-

⁴¹⁾ Përafërsisht kur të mbushin shtatë vjet.

rin e tyre, dhe për ta mbajtur lumturinë e shoqërisë dhe rrethit ku jeton. Zbulimi i femrës dhe zhveshja e saj shpie padyshim në shkatërrimin dhe çrregullimin e shoqërisë!

- Urdhëroji gratë e tua që të mbulohen edhe nga ata, që nuk i kanë të ndaluar për martesë si: djali i xhaxhait, djali i dajës, vëllai juaj etj., sepse sot gratë janë mësuar që nga personat e lartpërmendur të dalin të zbuluara (pa shami)!
- Mos prano që gratë tuaja të shkojnë te rrobaqepëset jomuslimane për t'i qepur veshjet e tyre!
- Tërhiqja vërejtjen grave tuaja që mos të dalin nga shtëpia me veshje pa mëngë ose me mëngë (krahë) të shkurtra, madje edhe nëse është ndër mantel, për arsye se mund të ballafaqohen me situata që kërkojnë shtrirjen e dorës apo krahut, si dhe era mund t'i zbulojë ato pa ndonjë qëllim!
- Tërhiqja vërejtjen grave tuaja që mos të veshin çorape të tejdukshme, e as çorape me ngjyra, përveç çorapeve me ngjyrë të zezë e të mbylltë, të cilat nuk kanë asnjë zbukurim!
- Mos lejo që gratë tuaja të veshin këpucë të zbukuruara të cilat tërheqin shikimin e meshkujve!
- Tërhiqja vërejtjen grave tuaja që të mos dalin në tregje e të shtyhen me burra të huaj dhe të zbulohen para shi-tësve, për arsye se Allahu ka xhelozitë karshi këtyre gjërave, po ashtu edhe besimtari xhelozon!
- Ndaloji gratë tuaja nga zotimi për të ndezur zjarre e qirinj tek varret e evlijave (njerëzve të devotshëm), ngase një gjë e tillë është e ndaluar juridikisht në Islam!
- Mos i lejoni gratë tuaja që të abstenojnë nga disa lloje të lejuara të ushqimit në shenjë afrimi tek Allahu, sepse edhe kjo gjë është e ndaluar sipas shariatit islam!

- Ndaloji gratë e tua që të mos dalin të përcjellin xhenazen (të mos marrin pjesë në ceremonitë mortore)!
- Mësoje gruan tënde dhe vajzat e tua që t'i ruajnë sekretet e burrave të tyre!
- Tërhiqja vërejtjen gruas dhe vajzave të tua që mos t'i lëndojnë burrat e tyre me ndonjë fjalë, vepër apo me ndonjë mosmarrëveshje tjetër!
- Këshilloji gratë e tua që të mos shoqërohen me gra të pambuluara nga frika e infektimit prej tyre, sepse të pajtuarit me gjynahe është mëkat gjithashtu!
- Mos lejo që gratë dhe vajzat e tua të marrin pjesë në dasma (ahengje; fejesa, martesë etj.) në të cilat këndohet, kërcëhet, vallëzohet dhe në të cilat ka muzikë!
- Ndaloji gratë e tua që të mos flasin në rrugë dhe të mos qeshin në vende të tilla!
- Këshilloji gratë që të mos flasin me mysafiret e tyre tek dyert (tek porta)!
- Tërhiqja vërejtjen grave dhe vajzave të tua që të mos flasin me burra të huaj, vetëm në raste të domosdoshme kur e kërkon nevoja, dhe në atë rast të flasin pas perdes dhe duke mos e thyer zërin e tyre gjatë bisedës!
- Mësoji grave të tua rëndësinë e qëndrimit të tyre në shtëpi, për shkak se ato janë krijuar me qëllim që t'i edukojnë fëmijët në shtëpi. Kur të dalin nga shtëpia mos të dalin pa pëlqimin e burrit!
- Mos lejo që gratë dhe vajzat e tua të dalin në piknik apo në vende dëfrimi të vetmuara, po ashtu të mos shkojnë në kinema, për shkak se atje do të mësojnë vetëm shthurje, turpëri e çrregullime!

KËSHILLA RRETH VESHJES

- Vendoseni çallmën dhe mbajeni kësulën, ngase një gjë e tillë është më e përshtatshme për muslimanin!
- Mos vishni rroba të gjata, që i tejkalojnë nyjet (zogjtë) e këmbëve si dhe mos ecni si arrogantë (mendjemadh)!
- Vishuni ashtu siç vishen muslimanët dhe mos i ngjani mosbesimtarëve dhe të degjeneruarve!
- Kur të visheni, filloni nga e djathta, kurse kur të zhvishe- ni, filloni nga e majta. Kjo këshillë vlen si për veshjen ashtu edhe për mbathjen e këpucëve!
- Mos e lejoni familjen tuaj (bashkëshorten) që të vishet me rroba të shkurtra dhe të ngushta, e as me pantallona ku mund të duket aureti - pjesët e turpshme të trupit ose mund të përshkruhet trupi i saj!
- Mos vishni mëndafsh, e as mos mbani ar, për shkak se veshja dhe mbajtja e tyre janë haram - të ndaluara për meshkujt!
- Mos i ngjani grave dhe mos lejoni që gratë tuaja t'i imi- tojnë burrat!⁴²

⁴²⁾ Përngjasimi i njëres gjini me tjetrën është i ndaluar në Islam dhe i Dërguari i quan të mallkuar ata meshkuj që në vete fusin gjeste të femrave, pra feministët dhe ato femra që ecin, vishen dhe marrin attribute të burrave. (Sh. P.)

- Largohuni nga veshja e rrobave që të dallojnë në shoqëri; si ato që janë të standardit shumë të lartë, po ashtu edhe ato që janë të standardit shumë të ulët!
- Kur të visheni me rroba të reja, ato të vjetrat jepini sadaka-lëmoshë!
- Lëshojeni mjekrën, sepse Pejgamberi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: “Shkurtojini mustaqet dhe lëshojini mjekrat!”⁴³

⁴³) Transmetohet nga Ibën Umeri se Pejgamberi, alejhi selam, ka thënë: “Kundërshtojini mushrikët, shkurtoni mustaqet dhe lëshoni mjekrat”. (Transmeton Buhariu dhe Muslimi). Transmetohet gjithashtu nga Ebu Umame se Pejgamberi, alejhi selam, ka thënë: “Shkurtoni mustaqet dhe lëshoni mjekrat. (Me këtë) Kundërshtoni Ehlul-Kitabët (hebrenjtë dhe të krishterët). (Transmeton Muslimi dhe katër Sunenet). Njëri prej dijetarëve të mëdhenj të Medh’hebit Hanefi Ibën Abidini thotë: “Meshkujve u ndalohet shkurtimi i mjekrës.” (shih: Reddul-Muhtar 2/418) (Sh. P.)

KËSHILLA RRETH USHQIMIT DHE PIJEVE

- Bëhuni modest, kënaquni edhe me të paktën dhe, sa të keni mundësi, hani vetëm nga pasuria që fitoni me duart tuaja!
- Mos hani asgjë tjetër, përveç ushqimit hallall dhe të mirë!⁴⁴
- Pastroni duart para dhe pas marrjes se ushqimit!
- Përmendeni emrin e Allahut para ngrënies dhe pirjes, duke thënë: Bismilah dhe kur ta mbaroni, falënderoje Atë duke thënë: Elhamdulillah!
- Ushqehuni dhe pini me dorën e djathtë dhe njëkohësisht edhe kur të merrni apo kur të jepni diçka, veproni me dorën e djathtë!
- Hani para vetes!

⁴⁴) Transmeton Taberaniu nga Ibën Abasi, i cili ka thënë se këtë ajet e lexova në praninë e Muhamedit, alejhi selam, dhe ai tha: “O ju njerëz, hani prej gjërave që gjenden në tokë, që janë hallall (të mira)!” Në këtë rast u ngrit në këmbë Sead ibën Ebi Vekkasi dhe tha: “O i Dërguari i Allahut, lute Allahun që lutjet e mia të jenë të pranuar.” Muhamedi, alejhi selam, tha: “O Sead, ushqehu me ushqim hallall dhe lutjet e tua do të jenë të pranuar. Pasha Atë që shpirti i Muhamedit është në Dorën e tij, ai njeri i cili e mbush barkun e tij me një kafshatë haram, Allahu nuk do t’i pranojë veprat nga ai për dyzet ditë. Trupi i atij njeriu që rritet me haram, do të digjet në zjarr.” (Sh. P.)

- Mos u ngopni gjatë marrjes së ushqimit!
- Mësojeni familjen dhe fëmijët tuaj që të hanë ushqim së bashku!
- Nëse jeni ftuar në ndonjë gosti, atëherë përgjigjuni ftesës, vetëm nëse në atë vend ka gjëra të ndaluara dhe të cilat nuk ke mundësi që t'i ndryshosh!
- Mos merrni pjesë në ndonjë manifestim - zijaftet - pa genë i ftuar!
- Mos hani ushqim në asnjë vend tjetër përveçse tek njerëzit e devotshëm (që ia kanë frikën vetëm Allahut), si dhe mos lejoni që ushqimin tuaj ta hajë dikush tjetër përveç të devotshmëve!
- Mos i përdorni enët e arit dhe të argjendit, sepse ato janë rreptësisht të ndaluara!
- Mysafirin nderoje dhe mos u bëni as dorështrënguar (koprrac), e as mos e teproni në shpenzime!
- Nëse shkoni diku mysafir, mos e mundoni shumë (mos e bezdisni)!
- Kafshët që janë të lejuara për t'u therur, therini ashtu si duhet, si dhe ato që na janë lejuar t'i mbysim sipas she-riatit, mbytini mirë dhe mos e ndëshkoni asnjë krijesë të gjallë!

KËSHILLA RRETH PUSHTETIT - LIDERSHIPIT

- Keni kujdes nga pozita dhe pushteti, sepse në të shumtën e rasteve ajo është një humbje e madhe!
- Nëse ngarkoheni me ndonjë post, atëherë bëhuni të drejtë ndaj njerëzve!
- Merre pranë vetes një vëlla, i cili të këshillon si dhe konsultohuni me njerëz për çdo gjë!
- Ruajuni nga padrejtësia ndaj të tjerëve, ngase në Ditën e Kijametit ajo do të jetë errësirë!
- Ruaju nga ryshfeti!⁴⁵
- Kur të zgjidhni dikë për zëvendës apo mëkëmbës, zgjidhni më të mirin dhe më të dobishmin!
- Udhëheqësit respektojini në çdo gjë të ligjshme dhe lutuni për ta për të mirë dhe që të udhëheqin mirë!
- Mos e lejoni veten që të hyni te udhëheqësit e padrejtë (zullumqarët), përveç nëse keni ndonjë nevojë të domosdoshme!

⁴⁵⁾ Si marrja e mitos, ashtu edhe dhënia e saj janë të ndaluara. Për këtë arsye autori porosit që të ruheni nga ryshfeti, duke mos e veçuar njëri anë, sepse që të dyja anët janë të ndaluara. Allahu na ruajtë nga kjo sëmundje shoqërore, e cila po merr përmasa çdo ditë e më shumë! (Sh. P.)

- Mos i ofroni ndihmë në programin e tij, udhëheqësit që thërret në gjëra të kota e as të padrejtit në padrejtësinë e tij!
- Mos syno kënaqësinë e njerëzve duke hidhëruar Allahun, Krijuesin e Gjithësisë!
- Bëhuni i drejtë dhe i qëndrueshëm dhe mos u frikësoni nga kritikata e as mos kërkoni falënderim nga të tjerët!
- Largohuni nga dëshmia e rrejshme dhe mos e mbuloni të vërtetën!

KËSHILLA KUNDËR VEPRAVE PENALE

- Mos i bëni lajka (mos e ledhatoni) askujt dhe mos keni frikë nga asnjë kërcënim kur jeni duke punuar në rrugën e Allahut Fuqiplotë!
- Urdhëroni për të mirë, ndaloni nga e keqja dhe bëhuni i durueshëm nga ajo që ju ka goditur!
- Ruajuni që fjalët dhe këshillat të mos bien ndesh me veprat tuaja!
- Mos toleroni në ndëshkimin e shkelësve të ligjeve të Allahut!⁴⁶
- Mbulojini të metat e muslimanit dhe mos ia shpalosni ato!
- Largohuni nga të gjitha gjërat e ndaluara, qofshin të vogla apo të mëdha, mos bëni gjynahe ndaj Allahut dhe mos e ndihmoni asnjë që Atij t'i bëjë gjynahe!
- Mëkatet e vogla mos i nënvleftësoni duke i shikuar si të vogla, sepse trajtimi i tillë ndaj tyre është shkatërrues!
- Ruajuni nga konsumimi (pirja) e alkoolit; shitja, blerja dhe ulja me njerëz të cilët konsumojnë alkoolin!⁴⁷

⁴⁶) Mos e ndihmoni asnjë kur është në pyetje mosrespektimi dhe moszbatimi i ligjeve të Allahut!

⁴⁷) Alkooli është pothuajse i barabartë me shirkun. Transmetohet nga Ibën Abasi se ka thënë: "Pasi ka zbritur ndalesa për alkoolin,

- Mos iu afroni imoralitetit (zinasë)! Me të vërtetë imoraliteti është vepër e fëlliqur, shkakton hidhërimin e Allahut dhe është një rrugë shumë e keqe!
- Ruaju nga homoseksualizmi!⁴⁸
- Keni kujdes nga mbytja e njeriut, sepse mbytja llogaritet ndër gjynahet më të mëdha!

shokët (sahabët) kanë shkuar te njëri-tjetri, duke thënë: *“U ndalua alkooli dhe është bërë i barabartë me shirkun.”* Gjithashtu tregohet se Ibën Umeri anonte nga ajo se alkooli është gjynahu më i madh. Në shumë thënie profetike (hadithe) të cilat flasin rreth ndëshkimit dhe mallkimit të konsumuesit të alkoolit, Pejgamberi, alejhis elam, thotë: *“Kur vdes konsumuesi i alkoolit, do ta takojë Allahun si adhurues të idhujve.”* (Transmeton Buhariu në Tarih el-Kebir 1/129; Ahmedi në Musned 1/272, Ibën Maxhe 2/1120 nr. 3375). (Sh. P.)

⁴⁸⁾ Allahu i Madhërishëm në lidhje me këtë thotë: *“A shkoni pas meshkujve të kësaj bote, e gratë tuaja i leni anash, të cilat Zoti i krijoi për ju?! Ju jeni një popull që kaloni çdo kufi!”* (Sure Shuara’a: 165-167). Edhe i Dërguari i Allahut, Muhamedi, alejhi selam, ka thënë: *“Allahu e ka mallkuar atë që e bën veprën e popullit të Lutit.”* Po ashtu, në lidhje me homoseksualitetin dhe vepruesin e saj, Resulullahu, alejhi selam, ka thënë: *“Mbyteni vepruesin dhe atë mbi të cilin veprohet.”* (Ebu Davudi 4/158, nr. 4462; vlen të përmendet se për saktësinë e këtij hadithi, mund t’i referoheni librit: Telhisuhabir 4/54). (Sh. P.)

KËSHILLA RRETH MIRËSJELLJES DHE MIQËSISË

- Silluni mirë ndaj prindërve dhe keni kujdes nga mosrespektimi i tyre!
- Farefisnin vizitoheni shpesh dhe ruajuni që të mos i ndërpreni lidhjet me ta!
- Bëhuni i mëshirshëm ndaj jetimit dhe nderojeni atë!
- Silluni mirë ndaj fqinjit! Mos e dëmtoni atë dhe duroni nëse ai ju shkakton ndonjë të keqe!
- Njerëzit e mirë vizitohuni sa më shpesh, gjithashtu edhe vëllezërit me të cilët të lidh feja e Allahut të Madhërishtëm, dhe shkëmbeni vizita me ta!
- Dashuroni vetëm për hir të Allahut dhe urreni po ashtu vetëm për hir të Allahut, ngase kjo është prej lidhjeve më të forta të besimit!
- Shoqërohuni me njerëz të mirë dhe ruajuni nga shoqëria e keqe dhe e brishtë!
- Mos u ulni me gjynahqarët, të cilët i bëjnë gjynahe Allahut dhe mos i dëgjoni as bisedat e tyre!
- Mbillni pemë frytdhënëse duke i shërbyer vetes dhe të tjerëve!
- Nëse dikujt i keni dhënë diçka, mos ia kërkonit atë përsëri!
- Shpejtoni që t'i mbulonit nevojat e muslimanëve dhe tek ata fut gëzim dhe hare!

KËSHILLA RRETH EDUKATËS (EDEBIT)

- Emrin Allah madhërojeni sa herë që ta përmendni Atë duke thënë “Azze ve xhel-le” - i Madhëruar qoftë, e të ngjashme!
- Dërgoni salavate (përsëndetje) mbi të dërguarin e njerëzisë Muhamedin, lavdërimi dhe paqja e Allahut qofshin mbi të, sa herë që të përmendet emri i tij!
- Emrat e njerëzve të devotshëm (evliave) përmendini me edukatë duke thënë: Allahu qoftë i kënaqur me ta. Mos harroni se nuk është prej evliave çdo person të cilit i është ndërtuar monument varri apo tyrbe!
- Bëhuni i turpshëm dhe keni kujdes nga arroganca dhe kokëfortësia, për shkak se turpi sjell vetëm të mira!
- Me njerëzit komunikoni sipas nivelit të tyre intelektual!
- Largohuni nga sharjet (fjalët e pahijshme) dhe poshtërsitë e tjera!
- Pajisuni me sjellje dhe moral të mirë, ngase më i miri prej njerëzve është ai i cili posedon moralin (edukatën) më të mirë!
- Largojeni hidhërimin nga vetja juaj dhe përmbahuni nga zemërimi i madh!

- Bëhuni sa më i butë, i matur dhe i kujdesshëm dhe ruajuni nga vrazhdësia dhe nxitimi (të shpejtuarit)!
- Fytyra juaj duhet të jetë e hapur, buzëqeshur dhe fjalët e tua duhet të jenë të mira dhe keni kujdes nga zymtësia!
- Mos i ndërhyjni tjetrit kur është duke folur, por dëgjoni me respekt!
- Mos u vetmoni që të flisni me dikë tjetër duke e lënë anash tjetrin kur jeni tre veta!
- Jepini selam atij që e njihni dhe atij që nuk e njihni!
- Selamin (përsëndetjen) thuajeni ashtu siç ka ardhur në sunetin e të Dërguarit, alejhi selam: “Esselamu Alejkum” e mos bëni me shenjë të dorës apo të kokës përveçse për ndonjë paralajmërim (këshillë)!
- Keni kujdes që të mos keni dëshirë që njerëzit të ngrihen në këmbë për ju!
- Përsëndetuni dorë për dorë me meshkujt, sepse kjo bën që të falen gjynahet!⁴⁹
- Mos hyni në shtëpinë e askujt pa marrë leje nga pronari dhe të lejohet hyrja!⁵⁰

⁴⁹) Qëllimi këtu është përsëndetja e burrave me burra, e assesi nuk duhet kuptuar si këshillë drejtuar grave, për arsye se grave u ndalohet përsëndetja me burra, për dore, gjë që tek ne është shumë e përhapur, bile po qe se gruaja mos t’i flasë për dore ndonjë burri, shkakton edhe ndërprerjen e raporteve familjare. (Sh. P.)

⁵⁰) Tek ne ky rend në përgjithësi është tejet i papërfillur. Është shqetësues fakti i mos-praktikimit të rregullave të hyrjes në shtëpinë e huaj, qoftë edhe tek vëllai nga nëna dhe babai. Allahu në Kur’an u drejtohet qartë besimtarëve duke u thënë: *“O besimtarë! Mos hyni në shtëpitë e huaja pa marrë leje e pa i përsëndetur banuesit e tyre. Kjo është më e mira për ju. Ndoshita do t’ia vini veshin!”* (Nur: 27) Sot këtë rregull

- Mos spiunoni e as mos e dëgjoni bisedën e atyre që nuk kanë dëshirë t'i dëgjoni!
- Largohuni në raste kur nëpër takime ka përzierje mes grash e burrash nëse vëreni dobësi në fenë tuaj!
- Mos e braktisni askënd përveç se për hir të Allahut, dhe gjithashtu largohuni nga grindja dhe konflikti!
- Mos e ofendoni askënd dhe për asnjërin mos i përshkruani vetitë e tij të këqija!
- Mos e mallkoni askënd në këtë botë, as kafshët e as gjërat e ngurta!

e respektojnë shumë pak nga njerëzit e afërm të një familjeje, duke menduar se jemi të gjithë të afërm. A thua harrojnë këta njerëz se fëmijët janë edhe më të afërm për prindërit e tyre, por megjithatë duhet të marrin leje kur hyjnë në dhomën e prindërve të tyre. Është gjë e thjeshtë t'i bihet ziles, apo të thërritet me zë. Ky formalitet nuk duhet kuptuar se është sinjal i largimit dhe distancës në mes të afërmeve. Përkundrazi, duhet kuptuar si rregull islam, që krijon qetësinë në familje dhe mirëpritjen e të afërmeve, pasi kjo duhet të ndodhë në mënyrë të ndërsjellë. Pra, siç thërret një person kur shkon tek xhaxhai i tij p.sh., ashtu edhe xhaxhai thërret kur shkon tek ai. Nëse ky formalitet i thjeshtë i duket i vështirë njerëzve, atëherë si do të ishte gjendja për ta praktikuar pa u hidhëruar rregullin e ardhshëm në ajetin në vazhdim nga e njëjta sure, ku Allahu vazhdon e thotë: *“Nëse atje nuk gjeni asnjë, mos hyni derisa t’ju lejohet e, në qoftë se ju thuhet “Kthelhuni”, atëherë kthelhuni! Kjo është më e mirë për ju. Allahu e di se çfarë bëni ju.”* (Nur, 28) Është e vërtetë e pamohuar që femra ka të drejtë të qëndrojë pa shami kur është në ambientet e shtëpisë së vet. Nëse aty ka meshkuj që i ka të afërm dhe nuk i lejohet martesat me ta si: babai, vëllai, xhaxhai etj., nuk është problem që femra të qëndrojë pa shami. Ndërsa të tjerat që janë në ambientet e shtëpisë martesore, ku të tjerët pos burrit i ka të huaj; si kunatin, xhaxhain e burrit etj., nuk i lejohet të jetë pa shami. (Sh. P.)

- Keni kujdes nga shpifjet dhe akuzat e njerëzve në çështjet që kanë të bëjnë me nderin dhe moralin e tyre, ngase kjo bën pjesë në gjynahet më të mëdha!
- Mos e trembni asnjë musliman e as mos e dëmtoni atë!
- Përpiquni që t'i pajtoni njerëzit në mes vete, qoftë edhe duke përdorur gënjeshtren e lejuar!⁵¹
- Nëse ndokush ju ka kërkuar falje, atëherë pranojani arsyetimin. Madje përpiquni që para se të kërkojë ai falje, ta arsyetoni atë!
- Mos e etiketoni askënd me llagape e emra të këqij, e as mos i thirrni ata me ofiqe të tilla, por thirrini ata me emrat më të dashur dhe më të preferuar për ta!
- Ruajuni nga *nemime*! Nemime është mbartja e fjalëve në mes njerëzve duke pasur si qëllim prishjen ndërmjet tyre.
- Keni kujdes nga përgojimi (gibeti)⁵²! Gibet është kur të flisni për vëllanë tuaj në mospraninë e tij për gjërat që ai nuk dëshiron t'i përmenden.

⁵¹) Me termin “الكذب المباح” gënjeshtër e lejuar, është për qëllim që të dëmtuarit t'i thoni: filani flet gjithmonë mirë për ty, edhe pse faktikisht nuk flet për atë as mirë e as keq, apo ta lavdërosh njërin duke mos qenë i pranishëm tjetri. (Sh. P.)

⁵²) Gibeti (përgojimi) është kur t'i përmendësh vëllait tënd diçka që ai e urren, qoftë kjo mangësi në trupin e tij, në prejardhjen e tij, në moralin e tij, në veprimet e tij, në thëniet e tij, deri edhe në veshjet (rrobat) e tij, në shtëpinë e tij dhe në kafshët e tij. Nga Enesi (Allahu qoftë i kënaqur me të), transmetohet se i Dërguari i Allahut, Muhamedi, alejhi selam, ka thënë: “Kur u ngrita në qiell (Natën e Mi'raxhit), kalova tek një popull që kishin thonj bakri dhe me to gërvishnin fytyrat dhe gjokset e tyre. Unë thashë: kush janë këta o Xhibril? Ai tha: Këta janë ata të cilët i hanë mishrat e njerëzve, d.m.th. përgojojnë dhe cenojnë nderet e njerëzve. Në lidhje me gabetin, i Dërguari i Allahut, alejhi selam, po

- Mos shpif për askënd e as mos e poshtëroni atë!
- Mos i kushtoni rëndësi dëgjimit të gjërave për të cilat nuk lejohet të flitet!
- Mos shkruani asgjë nga ajo që është ndaluar të flitet ose të dëgjohej për të!
- Krijoni mendime të mira për njerëzit dhe largohuni nga paragjykimet, sepse padyshim se disa mendime të këqija janë mëkat!
- Flisni të mirën, përndryshe heshtni!
- Bëhuni zemërmirë dhe mos u bëni ziliqarë e as dashakeqës!
- Bëhuni modest dhe mos u bëni mendjemadh e as mos u krenoni para të tjerëve!
- Mos u dashuroni me veten dhe me punët tuaja!
- Mos e lavdëroni veten dhe mos pretendoni atë që nuk e posedoni në vete!
- Mëkatarit, bidatçiu (shpikësit të gjërave të reja në fe), mosbesimtarit etj. mos ju thoni “zotëria im”!
- Jini të sinqertë dhe mos gënjeni, sepse gënjeshtria është prej gjynaheve më të mëdha!

ashtu thotë: *“A e dini se ç’është gibeti? Të pranishmit thanë: Allahu dhe i dërguari i Tij e dinë më mirë! Atëherë tha: “Gibeti është që t’i përmendni vëllait tuaj atë që ai e urren”. Thanë: Po nëse ai e posedon këtë cilësi? I Dërguari, alejhi selam, u përgjigj: Nëse ai e posedon këtë cilësi, atëherë e keni përgjuar, por nëse nuk e ka, atëherë keni shpifur ndaj tij”. Është më rëndësi për t’u shënuar se përgojimi është i ndaluar unanimisht nga të gjithë dijetarët e ummetit islam, bile Imam Kurtubiu ka thënë: “Dijetarët kanë rënë në ujdë se përgojimi është prej gjynaheve të mëdha dhe për këtë mëkat obligohet pendimi.” (Sh. P.)*

- Mos u bëni dyfytyrësh; pranë disave paraqiteni me një fytyrë kurse pranë disa të tjerëve me fytyrë tjetër!
- Mos u betoni në emrin e dikujt tjetër përveç Emrit të Allahut Fuqiptotë dhe mos e shpeshtoni betimin qoftë edhe për gjëra të vërteta!
- Mos e përçmoni askënd, për arsye se nuk ka asnjë dallim në mes njerëzve përveç atyre që dallohen me devotshmëri si dhe gjërat gjykohen sipas përfundimit të tyre!
- Largoni çdo pengesë nga rruga!
- Mos e kaloni kohën duke qëndruar rrugëve, nëpër kafe-ne si dhe mos hyni në vende të dëfrimit (klube të natës, kinema, diskoteka etj.)!
- Realizojeni premtimin e dhënë e mos tradhtoni, e as mos tradhtoni!
- Mos kërkoni ndihmë nga magjistarët dhe fallxhorët, e as mos ju besoni gënjeshtreve të tyre, e pastaj të shkatërrohen veprat që keni bërë!⁵³
- Mos bëni skulptura me pamje të njerëzve apo të kafshëve, për arsye se Ditën e Llogarisë dënimin më të dhembshëm do ta kenë skulptorët!

⁵³) I Dërguari i Allahut ka thënë: “*Kush shkon te falltari dhe i beson asaj që thotë ai, ai ka mohuar atë që i është zbritur Muhamedit (Islamin)*”.

Nga ky hadith nënkuptohet se vet shkuarja tek falltari është mëkat i madh. Por nëse ajo kurorëzohet edhe me besim ndaj fjalëve dhe veprës së falltarit, kjo gjë të shndërron në mosbesimtar apo jomusliman, pra si mohues i shpalljes së Allahut. Si i tillë nënkupton se bëhesh mosbesimtar dhe çdo vepër e mirë e juaja do të shkojë huq pasi besimi ka ikur nga zemra juaj dhe si përfundim do të jetë ndëshkimi me zjarr e jo shpërblimi me Xhenet. Allahu na ruajtë prej zjarrit të Xhehenemit! (Sh. P.)

- Mos i madhëroni fotografitë e njerëzve dhe të gjallesave duke i varur ato nëpër muret e shtëpive tuaja, apo duke u kushtuar atyre rëndësi të posaçme! Me këtë veprim do të ndaloni hyrjen e engjëjve (melekëve) brenda në shtëpi!
- Mos luani me zare e as lojë tavlle dhe lojëra të tjera të ngjashme!
- Mos këndonit vargje të thurura me përmbajtje të prishur dhe të shfrenuar dhe as mos e lejoni veten që t'i dëgjoni ato!
- Mos dëgjoni gjëra dëfryese e as vegla muzikore, duke përfshirë këtu edhe tupanët e darabukun! Keni kujdes po ashtu në posedimin e tyre!
- Mos luani me fluturimin e pëllumbave!
- Mos e mbyllni në kafaz bilbilin dhe llojet e tjera të shpendëve!
- Mos flini mbi pllakën e parrethuar me mur apo parmakë!⁵⁴
- Mos flini përmbys, ngase kjo është mënyra e të fjeturit të shejtanit dhe kjo mënyrë e të fjeturit e hidhëron Allahun e Madhërishëm!⁵⁵

⁵⁴) I Dërguari po ashtu porositi që mos ta neglizhojmë sigurinë gjatë gjumit, sepse ai nuk është në gjendje të dijë se çfarë vepron. Prandaj njeriu e ka të ndaluar të flejë në një vend të ngritur e që nuk është i rrethuar. Ai, lavdërimi dhe paqja e Allahut qofshin mbi të, ka thënë: *“Kush flenë në pllakën e shtëpisë (vendin) të parrethuar, mos ta fajësojë askënd për pasojat e mundshme!”* (Sahih, Buhariu në “El-Edebul Mufred” etj.) (Sh. P.)

⁵⁵) Tihfe El-Gifari ishte një varfanjak që jetonte në xhaminë e Muhamedit, alejhi salatu ve selam. Ai tregon se një ditë më gjeti i Dërguari, lavdërimi dhe paqja e Allahut qofshin mbi të, duke fjetur në

- Mos u ulni në mes të hijes dhe rrezeve të diellit!⁵⁶
- Mos e hapni gojën kur të gogësin (kur t'ju marrë gjumi), por mbulojeni atë me shpinën e dorës së majtë. Mos e ngreni zërin gjatë teshtimës dhe gromësirës!
- Kur të teshtijë dikush, thoni: “Jerhamukallah” (Allahu ju mëshiroftë), pasi ai të ketë thënë: “Elhamdulillah” (Falënderuar qoftë Allahu). Më pas ai le të përgjigjet me lutjen: “Jehdikumullahu ve juslih balekum” (Allahu ju udhëzofte dhe jua përmirësoftë mendimin tuaj)!
- Mos u bëni pesimist nga asgjë dhe mos mendoni se dikush tjetër ka ndikim në një veprim të caktuar përpos Allahut!⁵⁷

xhami përmbys. Më tundi me këmbën e tij dhe më tha: “Pse flen në këtë mënyrë? Këtë mënyrë të fjeturi e urren Allahu!” (Transmeton Ibn Maxhe dhe të tjerë, hadithi është sahih) Në një transmetim tjetër Ebu Dherrit i tha: “O karkalec i vogël, kjo është mënyra e të fjeturit të banorëve të zjarrit!” (Sahih, Ibni Maxhe)

Pra shkaku i ndalimit të kësaj mënyre të fjeturi është mospërngjasimi me banorët e Xhehenemit. (Sh. P.)

⁵⁶) Ibn Maxhe transmeton (hadithi është sahih) se “i Dërguari, lavdërimi dhe paqja e Allahut qofshin mbi të, e kishte ndaluar që njerëzit të ulen në mes të hijes dhe diellit!” Në disa transmetime të tjera sqarohet shkaku i këtij ndalimi, ku përmendet se në ato vende qëndron shejtani i mallkuar. (Sh. P.)

⁵⁷) Në këtë këshillë ka porosi shumë të dobishme, që lidhet ngushtë me besimin e pastër të muslimanit. Me të vërtetë Allahu gjërat në këtë botë i ka lidhur me shkaqet e ndodhjes së tyre, por asnjëherë nuk duhet harruar se vetë shkaqet janë krijesa apo mundësi të Allahut. Andaj shikuar në fund del se gjithçka që ndodh është caktim dhe dëshirë e Allahut dhe asnjë krijesë nuk mund të jetë ndikuesi i drejtpërdrejtë në shkaktimin e ndodhjeve dhe ngjarjeve të caktuara. Kur kjo gjë do të kuptohej drejt, shumë zënka e hidhërimi që ndodhin në mesin e njerëzve do të tejkaloheshin më lehtë e me më pak

- Mos u varni këmbore bagëtive e as mos mbani qen në shtëpi përveç nëse keni nevojë për gjueti apo për ruajtjen e pasurisë!
- Ruajuni nga fishkëllima dhe duartrokitja, sepse ato janë gjeste të mosbesimtarëve!

pasoja. Falja dhe toleranca do të shfaqej më shumë. Vëllai nuk do ta konsideronte vëllanë si armikun kryesor dhe shkaktarin e vetëm të ndonjë dëmi në rast se sprovohet me të. Allahu na udhëzoftë në rrugën e Tij të vetme e të drejtë! (Sh. P.)

SË FUNDI

- Bëhuni asket në kënaqësitë e dynjasë dhe synues i kënaqësive të ahiretit!
- Nga kjo botë mos merrni asgjë më shumë se çfarë ju mjafton për nevojat tuaja, sepse përndryshe do të merrni kalbësirën!
- Shpejtoni në pendim për të gjitha mëkatet që keni vepruar dhe veprat e këqija pasojini me të mira, të cilat i shlyejnë të këqijat! Gjithashtu keni kujdes nga zvarritja e pendesës duke e shtyrë për më vonë!
- Gjatë pendimit tuaj; ndieni keqardhje për atë që keni vepruar (veprat e këqija), bëhuni i vendosur se nuk do të ktheheni më në mëkate dhe shpeshtoni Istigfarin (kërkoni falje sa më shpesh duke thënë “Estagfirullah”). Po ashtu, nxitoni në kompensimin e veprave që ju kanë kaluar si: namazi, zekati, agjërimi dhe të ngjashme me to! Orvatuni që njerëzve t’ua ktheni borxhet dhe të drejtat e tyre që i keni pasur obligim karshi tyre duke i mbartur edhe pasojat e tyre!
- Dedikoni kohë për adhurim sa të keni mundësi dhe drejtohuni nga Allahu duke i respektuar urdhrat e Tij!
- Shpeshtojini punët e mira, e në veçanti në kohën e fesatit dhe kesatit (kur popullin e kaplon shkatërrimi dhe prishja e moralit)!

- Vazhdoni me punë të mira, sepse me të vërtetë puna më e dashur tek Allahu është ajo që kryhet në vazhdimësi, edhe pse është e paktë!
- Mos t'ju brengosin çështjet e kësaj bote! Mos t'ju frikësojë varfëria, por kërkon mbrojtje tek Allahu që t'ju ruajë nga ajo, sepse kërkitimi i mbrojtjes tek Allahu është veçori e njerëzve të mirë.
- Kënaquni me atë që Allahu i Madhërishtëm ka caktuar për ju dhe mos shfaqni pakënaqësi!
- Largojeni syrin nga pasuria e njerëzve, do të duan njerëzit dhe njëherësh do bëheni i pasur, si dhe largojeni syrin nga kjo botë, do t'ju dojë Allahu i Madhërishtëm!
- Mos shikoni në atë që është më i ulët (dobët) se ju në çështjet fetare, por shiko dhe merrni shembull nga ata që janë më të mirë dhe më të ngritur (fetarisht)!⁵⁸

⁵⁸⁾ Në lidhje me këtë do të citoj thëniet e Ebu Derdas kur përkthyer ata të cilët jepen pas kënaqësive të kësaj bote, i harrojnë dëmet e mëkateve, për arsye se nuk shikojnë në atë që është më i ngritur nga ana fetare. Ja se ç' thotë Ebu Derda: "Tre veta më bëjnë të qesh ndërsa tre të tjerë më bëjnë të qaj. Më bëjnë të qesh: Njeriu që shpreson një jetë të gjatë edhe pse vdekja e kërkon gjithkund, njeriu i cili është i pakujdesshëm edhe pse e di se nuk do të lihet në pakujdesi, njeriu i cili qesh shumë, ndërsa nuk e di nëse është i kënaqur Krijuesi e Zoti i tij me të apo jo. Ndërsa më bëjnë të qaj: Frika nga fundi, ndalimi i punës dhe qëndrimi para Allahut, kur njeriu do të presë që Allahu t'ia caktojë vendin në Xhenet apo në Xhehenem. Halifi Umer Ibn Abdulazizi ka kërkuar prej Hasanit që ta këshillojë. Duke ia plotësuar dëshirën, ai ka thënë: "O sundues i besimtarëve! Ajo që ka qenë - sikur të mos ketë qenë fare, a ajo që do të vijë - sikur të jetë tani! Dije, o sundues i të drejtëve se është e mrekullueshme shija e asaj që vjen pas durimit, madje edhe nëse e shijon hidhësinë e atij durimi! Ndërsa, shija e përfundimit të bukur është më e këndshme. Pasoja e kënaqjes së lakmive trupore është

- Mos shiko në atë që është më i ngritur se ju në çështjet e kësaj bote (dynjasë), por merr mësim nga ai që është më keq se ju!
- Hulumtoni gjërat e lejuara - hallall, ngase ky është obligim pas obligimeve (farzeve) të caktuara të Allahut!
- Mos hani asgjë nga ajo që është e vjedhur, përndryshe do të përfshiheni në atë mëkat!
- Ushqehuni me ushqim hallall, do t'ju pranohen lutjet (du'atë)!
- Bëhuni si bleta, e cila ushqehet me gjëra të mira dhe bën gjëra (prodhime) të mira!
- Mes jush dhe të ndaluarës - haramit, vendosni një perde nga hallalli!
- Ruajeni gjuhën dhe mos flisni për atë që nuk ju takon, për shkak se kjo është cilësi e fetarisë së lartë të muslimanit!
- Bëhuni i besueshëm, sepse ai që nuk është i besueshëm, nuk posedon as fe (din)!

gjithsesi e hidhët dhe ajo medoemos do të arrijë edhe nëse për një moment e shijon kënaqësinë e saj. Ndërkaq, rezultati përfundimtar i gjithë kësaj do të jetë i kobshëm për atë që shkon pas epsheve të veta. Dije, o sundues i të besueshmëve, se do të shpëtojë vetëm ai që ruhet nga mëkatet dhe që përkujdeset që ta fitojë shpëtimin në shtëpinë e amshueshme. Ai do ta meritojë edhe mëshirën e Allahut dhe do të hyjë në Xhenet. Ky është një shembull që duhet pasuar, kush ishin këta njerëz të cilët i respektonin të diturit edhe pse ata posedonin njohuri, mirëpo njohësit e fesë i respektonin edhe më shumë dhe nuk ngurrnin t'i pyesnin për çështjet e kësaj bote dhe botës tjetër. Sot është e vështirë të hasësh ndonjë prijës që të pyesë apo të këshillohet me njohësit (thirrësit) islamë. (Sh. P.)

- Frikësojuni shumë Allahut dhe mos u bëni i guximshëm kundër Tij!
- Shpresoni në faljen e Allahut të Madhërishëm dhe në mëshirën e Tij dhe kini mendim të mirë për Allahun!
- Bëhuni i durueshëm kur të godasin sprovat dhe fatkeqësitë, dhe falënderues kur Allahu ju begaton me të mira!
- Mos u shqetësoni nga sprovat që ju godasin, e as mos u mërzitni për gjërat e dynjasë që ju ikin!
- Mos mbani hajmali, sepse një gjë e tillë është shirk (ortakëri ndaj Allahut) dhe kurohuni vetëm me anë të mënyrave të ligjshme islame!
- Shërohuni nga sëmundjet, se me të vërtetë Ai që i ka lëshuar sëmundjet, ka krijuar edhe ilaçin!
- Duaji muslimanët për hir të Allahut, Allahu do t'ju dojë juve!
- Vizitoni të sëmurit dhe solidarizohuni me ta duke ju dhënë gjatet!
- Lutuni për shërimin e të sëmurëve edhe në mospraninë e tyre!
- Mos flini asnjë natë pa e shkruar testamentin dhe të jeni të drejtë në përmbajtjen e tij!
- Përgatituni për vdekjen para se të vijë!
- Përkujtoni sa më shpesh “shkatërruesin e kënaqësive” - vdekjen!
- Faleni namazin e xhenazes, përcilleni kufomën deri te varri, vizitoni varrezat dhe merrni mësim nga vdekja!
- Përgatisni ushqim për familjen e të vdekurit, ngase ata janë të zënë!

- Mos u ulni mbi varreza dhe ndalojini të tjerët që të ulen mbi to. Po ashtu, mos lejoni që të thyhen eshtrat e të vdekurve!
- Mos i zbukuroni varret dhe mos ndërtoni asgjë mbi to!
- Lutuni për të vdekurin që mëshira e Allahut Fuqiplotë ta mbulojë atë; përmendini vetëm anët pozitive të tij! Mos i fyeni të vdekurit sepse ata kanë shkuar në atë që kanë përgatitur më parë, dhe fyerja apo sharja e të vdekurve i lëndon të gjallët!
- Ruajuni nga vajtimi dhe nga ky fenomen tërhiqja vërej-tjen të tjerëve!
- Këshillojeni gruan tuaj që mos të mbajë zi më shumë se tri ditë, përveç për burrin e saj!
- Mos kaloni pranë varreve të zullumqarëve (tiranëve dhe mosbesimtarëve) dhe vendbanimeve të tyre duke qenë në shkujdesje rreth asaj që i ka goditur ata!
- Mos leni pas vete ndonjë gjurmë të keqe, siç janë veglat muzikore apo ndonjë libër që i shpie njerëzit në humnerë, e të ngjashme me to!
- Punoni sa më shumë vepra të mira, të cilat do të mundësojnë shpërblimin edhe pas vdekjes suaj, si p.sh: ndërtimi i xhamive, përhapja e diturisë etj.⁵⁹
- Pajisuni me devotshmëri (takva) dhe do të bëheni nga të dashurit e Allahut të Madhërishëm!
- Mos u bëni mendjemadh, e të bëheni nga krijesat më të këqija të Allahut!

⁵⁹⁾ Aktiviteti i mësim-besimit, ligjërata, libra, përkthime dhe shkri-me, broshura, tema të ndryshme, kujdesje për ndonjë faqe elektronike e të ngjashme. (Sh. P.)

- Luteni Allahun e Madhërishëm që t'ju shpërblejë me xhenet dhe kërkoni mbrojtjen e Allahut nga zjarri i xhenemit!
- Njihuni me atë që punon sipas ligjit (sheriatit) të Allahut dhe shoqërohuni me të në të praktikuarit e të gjitha këtyre këshillave!
- Fjala “La ilahe il-lallah” të jetë fjala më e sinqertë që thoni dhe fjala e fundit me të cilën largoheni nga kjo botë!

PËRMBAJTJA

FJALA E REDAKTORIT FETAR	5
400 KËSHILLA ISLAME	7
KËSHILLA RRETH PASTËRTISË.....	10
KËSHILLA RRETH ABDESIT.....	12
KËSHILLA RRETH GUSLIT	15
KËSHILLA RRETH NAMAZIT	17
KËSHILLA RRETH NAMAZIT TË XHUMASË	22
KËSHILLA RRETH SADAKASË - BAMIRËSISË	23
KËSHILLA RRETH AGJËRIMIT.....	25
KËSHILLA RRETH HAXHILLËKUT	27
KËSHILLA RRETH LUFTËS SË SHENJTË - XHIHADIT.....	30
KËSHILLA RRETH LEXIMIT TË KUR'ANIT	33
KËSHILLA RRETH TË PËRMENDURIT TË ALLAHUT (DHAKRIT) DHE LUTJEVE (DUAVE)	34
KËSHILLA RRETH SHITBLERJES	37
KËSHILLA RRETH BASHKËSHORTËSISË (NIKAHUT)	41
KËSHILLA RRETH VESHJES	46
KËSHILLA RRETH USHQIMIT DHE PIJEVE.....	48
KËSHILLA RRETH PUSHTETIT - LIDERSHIPIT.....	50
KËSHILLA KUNDËR VEPRAVE PENALE.....	52
KËSHILLA RRETH MIRËSJELLJES DHE MIQËSISË.....	54
KËSHILLA RRETH EDUKATËS (EDEBIT)	55
SË FUNDI.....	64
PËRMBAJTJA	70